



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 709 Akti**

**Nr. 704 Vendimi**  
**Tiranë, më 9.10.2023**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	Kryesuese
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 5.10.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Elidon Hysenaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës<sup>1</sup>.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket

<sup>1</sup> Aktualisht – sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit përgjatë seancës dëgjimore.

rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimin Elidon Hysenaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 5.10.2023 kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimin Elidon Hysenaj, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimin *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimin Elidon Hysenaj i është nënshtruar procedurave të rivlerësimin, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.12.2020 nga Komisioni, në përputhje me rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimin, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Etleda Çiftja, pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimin janë nisur procedurat e rivlerësimin, si vijojnë:
  - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016 pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK, në vijim AKSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimin profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimin të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
5. Gjatë hetimit administrativ, konkretisht, në datën 18.1.2021 është njoftuar subjekti i rivlerësimin për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti i rivlerësimin me anë të postës elektronike është shprehur mbi mospasjen e ndonjë konfliktit të interesit me të tre anëtarët e trupit gjykues.
6. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Elidon Hysenaj, me vendimin nr. 2, datë 21.9.2023, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit

4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

7. Në datën 26.9.2023, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 3.10.2023.
8. Ndonëse subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit pranë Komisionit për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ dhe për tërheqjen e dokumentacionit fizik dhe në formë elektronike, ai paraqiti papësimet në datën e caktuar nga Komisioni.
9. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike në datën 3.10.2023, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 3.10.2023, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 5.10.2023, duke njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

10. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 5.10.2023, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.
11. Në vijim, pasi dëgjoji relacionin, subjekti Elidon Hysenaj parashtroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 5.10.2023 u mbyll për të rifilluar më 9.10.2023 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

12. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

## **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

## A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

14. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:
- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
  - *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive;*
  - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
  - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
  - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
15. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
16. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

### 1. Apartament banimi me sipërfaqe 101.5 m<sup>2</sup> në \*\*\*, Tiranë

1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit apartament me sipërfaqe 101.5 m<sup>2</sup> të ndodhur pranë \*\*\*, Tiranë, fillimisht në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015, në vlerën 90.000 euro. Ai ka deklaruar se për këtë apartament është lidhur kontrata e porosisë nr. \*\*\*, datë 27.10.2011 dhe, nga çmimi total, shoqërive ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*” sh.p.k. u është likuiduar vlera 83.000 euro, ndërsa detyrimi i mbetur prej 7.000 euro do të likuidohej në momentin e regjistrimit të apartamentit.
2. Më tej, në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar lidhjen e kontratës së shitblerjes për pasurinë me nr. \*\*\*, datë 11.5.2016, si dhe likuidimin e detyrimit të mbetur prej 7.000 euro, duke specifikuar se 6.000 euro janë transferuar në llogarinë bankare të shoqërive ndërtuese, ndërsa 1.000 euro janë likuiduar *cash*.
3. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë në fjalë, duke detajuar burimin e përdorur për secilin nga këstet e paguara, si në vijim:
  - a. Shuma 7.000.000 lekë, e konvertuar në 53.000 euro, është kaluar në datën 25.10.2011 nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria e nënës së subjektit, në formë huaje, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit. Subjekti ka shpjeguar se shuma 7.000.000 lekë është krijuar nga të ardhurat e prindërve ndër vite, nga punësimet e tyre dhe nga shitja e një apartamenti në Vlorë, të cilat i janë dhënë në formë huaje me interes shoqërisë rentiere “\*\*\*”. Kjo shumë është tërhequr në vitin 1999, së bashku me interesat e përfituara.

- b. Shuma 30.000 euro është transferuar në llogarinë e shoqërisë në datën 7.11.2011 nga llogaria e bashkëshortes në Tirana Bank, nga kursimet familjare ndër vite. Subjekti ka shpjeguar se kjo shumë është krijuar nga të ardhurat e aktivitetit të bashkëshortes së tij A. H. (K.), person fizik.
  - c. Shuma 6.000 euro është likuiduar nëpërmjet transfertës bankare në llogarinë e shoqërive ndërtuese. Kjo shumë i është dhënë hua bashkëshortes nga babai i saj N. K., në datën 5.5.2016, me burim nga kursimet e tij ndër vite nga të ardhurat nga punësimi.
  - d. Shuma 1.000 euro është likuiduar *cash*, me burim nga kursimet e subjektit dhe bashkëshortes së tij.
4. Së bashku me deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kontratën e porosisë nr. \*\*\*, datë 27.10.2011, kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 11.5.2016, certifikatën e pronësisë dhe kartelën e pasurisë së apartamentit, të regjistruara në emër të tij dhe të bashkëshortes, si dhe mandatet e transfertave bankare për likuidimin e çmimit të blerjes, përkatësisht:
    - a. 53.000 euro (konvertuar nga ekuivalenti 7.478.300 lekë), transferuar në datën 25.10.2011 nëpërmjet BKT-së nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.;
    - b. 30.000 euro të transferuara në datën 7.11.2011 nëpërmjet Tirana Bank nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.;
    - c. 6.000 euro të depozituara *cash* në datën 5.5.2016 nëpërmjet BKT-së nga bashkëshortja e subjektit në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.
  5. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja<sup>2</sup>, por edhe nga kontrolli *online* në sistemin multifunksional të ASHK-së për institucionet, ka rezultuar se pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij me anë të dokumentacionit të sipërcituar.
  6. DPPPP-ja<sup>3</sup> ka bërë me dije se për z. Elidon Hysenaj është raportuar porositja e një apartamenti në vlerën 90.000 euro, në datën 24.11.2011, sipas kontratës nr. \*\*\*.
  7. Nisur nga mospërputhja e datës dhe e referencave të kontratës së porosisë të paraqitur nga subjekti, me këto të raportuara pranë DPPPP-së, Komisioni iu drejtua noterit publik me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2022, duke i kërkuar të paraqiste aktin në fjalë. Me shkresën e datës 7.2.2022, noteri publik ka përcjellë aktin e deklaruar edhe nga subjekti me nr. \*\*\*, datë 27.10.2011. Gjithashtu, ka përcjellë edhe aktin me referencat nr. \*\*\*, të datës 24.10.2011, i cili i referohej një kontrate porosie të nënshkruar mes një shoqërie tjetër ndërtuese dhe një porositësi, i cili nuk ishte subjekti i rivlerësimit.
  8. Komisioni ka ripërsëritur kërkesën drejtuar noteres, duke i kërkuar të vendoste në dispozicion kontratën e datës 24.11.2011, ku kjo e fundit me përgjigjen e datës 3.6.2022 ka bërë me dije se kontrata me referencat e kërkuara nr. \*\*\* i përket datës 24.10.2011 dhe jo datës 24.11.2011. Në vijim, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2022, Komisioni i ka kërkuar noteres të paraqiste kontratën e datës 24.11.2011, që i përket z. Hysenaj. Me

<sup>2</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2017.

<sup>3</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2021.

përgjigjen e datës 21.6.2022, noterja ka bërë me dije se z. Hysenaj i përket vetëm kontrata e porosisë nr. \*\*\*, datë 27.10.2011.

9. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2022, UKT-ja ka bërë me dije se në emër të z. Elidon Hysenaj rezultonte kontrata nr. \*\*. Kjo kontratë ka qenë e lidhur fillimisht në emër të shoqërisë së ndërtimit dhe është ndryshuar emri në datën 9.4.2012.
10. FSHU-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2021, ka bërë me dije se me gjeneralitetet Elidon Hysenaj figurojnë dy abonentë në Tiranë, nga ku njëra në kabinën “\*\*\*\*”, me adresë Selitë, ka rezultuar se përputhet me adresën dhe të dhënat e apartamentit në pronësi. Ndërsa për kontratën tjetër Komisioni i ka kërkuar FSHU-së me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 16.5.2022, të paraqesë dosjen e plotë. Në përgjigje të kërkesës, FSHU-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2022, ka paraqitur procesverbalin e verifikimit në terren në datën 3.6.2022, të kabinës \*\*\*, në \*\*\*, ku është bërë shënimi “Gjatë kontrollit në kabinën \*\*\*, kjo kontratë nuk gjendet. Anomali 55”.
11. Lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, duke i kërkuar të informonte lidhur me marrëdhënien e mundshme familjare, shoqërore, duke përfshirë edhe ekzistencën e konfliktit të interesit. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e depozituara, veç të tjerash, ka bashkëlidhur edhe përgjigjet<sup>4</sup> nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>5</sup>, Prokuroria e Përgjithshme<sup>6</sup>, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar<sup>7</sup>, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier<sup>8</sup>, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>9</sup> dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë<sup>10</sup> kanë bërë me dije se me shtetasit apo personat juridikë të listuar nuk rezultoi ndonjë çështje penale e shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit.
12. Sa më sipër, Komisioni në mënyrë të pavarur kreu hetime duke iu drejtuar organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>11</sup> dhe Sarandë<sup>12</sup>, të cilat informuan se lidhur me shtetasit e përmendur në këtë shkresë nuk rezulton që për periudhën 2008 – 2023 të jenë regjistruar procedime penale në ngarkim të tyre. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar informoi lidhur me dy çështje (me dy shtetas) nga të cilat njëra i kishte kaluar Prokurorisë së Rrethit Shkodër për kompetencë dhe tjetra ishte dërguar për gjykim. Nisur nga ky informacion, Komisioni iu drejtua të dyja institucioneve, nga përgjigjet respektive të të cilave<sup>13</sup> rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokurori që ka ndjekur këto çështje penale.

---

<sup>4</sup> Për shtetasit A. C., N. K., A. K.; shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; E. J.; S. K.; shoqëria “\*\*\*\*” shoqëria “\*\*\*\*”; shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., shtetasit P. B.; shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., S. K.; B. H.; A. S.; E. Sh.; Gj. Sh.; L. S.; E. M. A. M.; A. P.; P. S. A. S.; M. K.; Ll. P.; dhe V. D.

<sup>5</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2021, për periudhën janar - mars 2015 OPGJ dhe për periudhën dhjetor 2018 – shkurt 2019 si prokuror i komanduar pranë kësaj Prokurorie.

<sup>6</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.7.2021, se prokurori është komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme, vetëm për hetimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2015.

<sup>7</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2021, për periudhën tetor – nëntor 2015.

<sup>8</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2021, si OPGJ 2004 – 2005 nuk ka pasur nën hetim shtetasit dhe shoqëritë e përmendura.

<sup>9</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2021.

<sup>10</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2021, se nuk ka pasur nën hetim gjatë nëntorit 2015 e në vijim shtetasit dhe shoqëritë e cituara, përveç procedimit penal të shtetasit E. M. – çështje penale nr. \*\*\*, datë 12.5.2021, e cila pas kërkesës së subjektit të rivlerësimit për zëvendësimin e tij, kërkesa nuk është pranuar nga drejtuesi i Prokurorisë, duke e dërguar çështjen për gjykim.

<sup>11</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2023.

<sup>12</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 3.5.2023.

<sup>13</sup> Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2023, vuri në dispozicion vendimin e datës 17.10.2013 për dënimin e shtetasit V. D. – përfaqësuar nga prokurore E. I. Ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2023, ka depozituar vendimin e

## 1.1 Analizimi i burimeve të krijimit të pasurisë

### 1.1.1 Analiza e pagesës së këstit të parë

13. Në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se kësti i parë për blerjen e pasurisë në analizë prej 53.000 euro është likuiduar me anë të transfertës bankare të datës 25.10.2011 nga llogaria e bashkëshortes së subjektit të shoqëria shitëse/ndërtuese. Kjo shumë ka rezultuar e formuar nga:
- shuma 7.000.000 lekë e transferuar nga nëna e subjektit të bashkëshortja e këtij të fundit, në datën 25.10.2011, me përshkrimin “T. H. kalon te A. H. për blerje apartamenti”;
  - shuma 500.000 lekë e transferuar nga llogaria e personit fizik të bashkëshortes në po të njëjtën datë, me përshkrimin “Kalim fondi”. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogarinë bankare të personit fizik ka rezultuar se kjo shumë është krijuar nga pagesat e përfituara nga aktiviteti nga DRSKSH-ja, për rimbursimet, duke mos krijuar dyshime mbi ligjshmërinë e kësaj shume.
14. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 22.7.2021, të lëshuar nga prindërit e tij për njohje detyrimi, me anë të së cilës kanë deklaruar se i kanë dhënë hua djalit të tyre shumën 7.000.000 lekë për blerjen e një apartamenti në Tiranë dhe se kjo shumë i është transferuar bashkëshortes së tij në datën 25.10.2011. Ata kanë shtuar gjithashtu se nga kjo shumë u është kthyer shuma prej 4.500.000 lekësh dhe kanë mbetur ende 2.500.000 lekë për t’u shlyer.
15. Lidhur me burimin e ligjshëm të huas, në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, subjekti ka bërë me dije se prindërit e tij kanë investuar në shoqëritë huamarrëse “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*” vlerën 1.200.000 lekë, të përfituar nga shitja e një apartamenti në vitin 1993<sup>14</sup> dhe, në përfundim, prindërit kanë tërhequr shumën rreth 8.000.000 lekë.
16. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2021, të lëshuar nga Ministria e Financave, shoqëritë huamarrëse në administrim, e cila ka bërë me dije se babai i subjektit L. H. ka qenë kreditor pranë shoqërisë “\*\*\*\*”, me kontratën nr. \*\*\*, ku ka depozituar kapitalin 1.251.900 lekë dhe ka tërhequr vetëm 2.41% si kreditor, në shumën 30.130 lekë. Ndërsa, nëna e subjektit T. H. ka qenë kreditore në shoqërinë “\*\*\*\*” me kontratën nr. \*\*\*, datë 8.12.1996, ku ka depozituar shumën 19.421.345 lekë dhe ka tërhequr shumën kapital + interesa, në total 26.664.339 lekë. Po ashtu, znj. T. H. ka qenë kreditore edhe në shoqërinë “\*\*\*\*” me kontratën nr. \*\*\*, ku ka depozituar kapitalin prej 11.000.000 lekësh dhe ka tërhequr shumën totale prej 11.132.000 lekësh. Ky institucion ka informuar se nuk disponon dokumentacion që të tregojë datat e veprimeve të depozitimit apo tërheqjeve, por ka bërë me dije se kreditorët që depozitonin lekë në firmat piramidale kanë përfituar interesa që varionin nga 6% deri në 10% në muaj.
17. Me qëllim hetimin e plotë, Komisioni iu drejtua MFE-së<sup>15</sup>, e cila në përgjigje të kërkesave të Komisionit<sup>16</sup> ka konfirmuar informacionin e lartpërmendur. Më konkretisht, në datën

Prokurorisë së Rrethit Shkodër të vitit 2005, të hetuar nga prokurori P. P. për shtetasin N. K., por që nga gjeneralitetet nuk rezultoi të jetë i njëjti shtetas me atë që ka blerë automjetin në vitin 2010.

<sup>14</sup> Kontratë e shitblerjes së apartamentit datë 22.11.1993.

<sup>15</sup> Përkatësisht me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 31.2.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2022.

<sup>16</sup> Kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2022.

8.12.1996, nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. T. H., janë depozituar fillimisht shumat si në vijim, të konvertuara në vlerën 17.666.537 lekë:

- a. 8.040.300 DRM;
- b. 10.172.220 lekë;
- c. 4.920.000 lireta;
- d. 38.836 USD.

18. Më tej, kapitali është shtuar me shumat përkatësisht me 460.420 lekë, 7.509 USD, 1.292.700 DRM dhe 242.000 lireta, duke arritur kundërvleftën totale të investuar 19.421.345 lekë. Nga kartela e depozituesit ka rezultuar se në datën 1.10.1997, znj. H. ka tërhequr shumat:

- a. 9.333.000 DRM;
- b. 10.463.640 lekë;
- c. 5.162.000 lireta;
- d. 46.345 USD.

19. I pyetur në lidhje me shumat e investuara prej nënës së tij pranë shoqërisë “\*\*\*\*”, në ekuivalentin prej 19.421.345 lekësh, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka shpjeguar se nëna e tij, së bashku me disa të afërm, kanë bashkuar fondet e tyre për t’i investuar së bashku, në mënyrë që të përfitonin interesa më të lartë. Më pas, kur janë tërhequr fondet nga shoqëria “\*\*\*\*”, ato janë ndarë mes tyre, sipas pjesëve të investuara përkatësisht. Së bashku me shpjegimet e mësipërme, subjekti ka paraqitur disa deklarata noteriale të viteve 1999 – 2000 të të afërmeve, të cilët kanë deklaruar sa më sipër pretenduar nga subjekti. Nga shqyrtimi i deklaratave noteriale të paraqitura ka rezultuar se deklaruesit kanë marrë mbapsht nga znj. H. shumën 11.518.318 lekë, duke mbetur kështu për t’u tërhequr prej saj diferenca prej 7.903.027 lekësh. Nga kjo shumë e tërhequr ka rezultuar se shuma e investuar fillimisht prej prindërve të subjektit ka qenë 4.250.000 lekë, ndërsa interesat e fituar përgjatë periudhës 1996 – 1997 kanë qenë në masën 3.653.027 lekë.

20. Subjekti ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 3 se në vitet e mëpasshme, deri në vitin 2003, këto fonde janë mbajtur në shtëpi dhe nuk janë depozituar në sistemin bankar, duke paraqitur edhe një deklaratë noteriale të lëshuar nga babai i tij<sup>17</sup> në mbështetje të këtij deklarami.

21. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se nëna e subjektit ka depozituar shumën 8.300.000 lekë në ish-Bankën e Kursimeve<sup>18</sup>, në datën 11.5.2004, shumë e cila ka vijuar të qëndrojë e investuar në depozitë me afat apo edhe në bono thesari edhe më tej në Raiffeisen Bank. Znj. H. ka tërhequr shumën 6.996.300 lekë në datën 16.2.2009. Më pas, në datën 19.2.2009, znj. H. ka depozituar shumën 7.000.000 lekë në depozitë me afat në Tirana Bank, ku ka qëndruar e investuar deri në datën 24.5.2010, datë në të cilën është tërhequr së bashku me të ardhurat nga interesat e fituar në shumën totale 7.374.500 lekë. Në po të njëjtën datë, 24.5.2010, znj. H. ka depozituar shumën 7.350.000 lekë në depozitë me afat në BKT, që ka qëndruar e investuar së paku deri në tetor 2011, kur është transferuar shuma 7.000.000 lekë, në favor të bashkëshortes së subjektit për pagesën

<sup>17</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 11.2.2022.

<sup>18</sup> Raiffeisen Bank me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2021, vuri në dispozicion kartelën e depozitës së kursimit, çelur më 21.2.2005, në emër të znj. T. H., në shumën 8.000.000 lekë, duke shpjeguar se shuma është mbartur nga Banka e Kursimeve. Subjekti ka paraqitur librezën e kursimit në emër të nënës së tij, në të cilën pasqyrohet depozitimi i shumës 8.300.000 lekë në datën 11.5.2004.



e kështit të parë të blerjes së apartamentit. Nga dokumentacioni i administruar nga BKT-ja ka rezultuar se depozitimi i shumës 7.350.000 lekë ka pasur shënimin “Çel depozitë nga shitja e apartamentit”.

22. Komisioni iu drejtua subjektit nëpërmjet pyetësorit nr. 4 lidhur me burimin e këtyre fondeve. Subjekti paraqiti deklaratën noteriale të prindërve të datës 25.2.2022, ku ata janë shprehur se nuk kujtojnë arsye për këtë shënim dhe se nuk kanë shitur asnjë apartament gjatë kësaj periudhe. Për më tepër, tërheqja nga Tirana Bank dhe depozitimi në BKT janë kryer në të njëjtën ditë, me rreth 25 minuta diferencë dhe në të njëjtën shumë. Subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2022, nga Tirana Bank dhe nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2022, nga BKT-ja, për të provuar largësinë mes degëve të tyre në Vlorë.
23. Komisioni ka hetuar edhe prindërit e subjektit, me qëllim verifikimin e ndonjë investimi të mundshëm të kryer prej tyre në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar për këtë qëllim ka rezultuar se nuk ka pasur investime në pasuri të paluajtshme<sup>19</sup> prej tyre përgjatë periudhës nga depozitimi i parave e deri në momentin e transferimit të tyre në favor të subjektit, si dhe nuk ka pasur prej tyre ndonjë investim tjetër nëpër depozita, llogari apo bono thesari nëpër bankat e nivelit të dytë.
24. Nisur nga fakti se shuma e dhënë hua nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, ndonëse rezulton të ketë buruar nga një situatë jo e provuar plotësisht me dokumentacion ligjor për sa i takon: (i) mënyrës së bashkimit të kapitaleve nga shtetas të ndryshëm, të cilët i kanë dhënë hua nënës së subjektit dhe krijimit më pas të investimit nga ana e prindërve të tij; (ii) masës së investuar fillimisht prej prindërve të tij; (iii) masës totale të përfituar në përfundim, ka rezultuar se nuk ndërlihdeshin me veprime të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, për aq kohë sa kjo shumë ka qenë e investuar në sistemin bankar në depozitë me afat në vijimësi, së paku prej vitit 2004, shumë vite më parë se subjekti të ushtronte detyrën si prokuror në vitin 2015 dhe duke mbajtur në konsideratë ekzistencën e dokumentacionit të viteve 1996 – 1999, që ka rezultuar se provon në mënyrë të tërthortë shumat e tërhequra prej prindërve të subjektit nga investimi në firmën piramidale “\*\*\*\*”.
25. Ndërsa për shumën e investuar fillimisht prej 4.250.000 lekësh nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, ky i fundit ka bërë me dije se kjo shumë ka ardhur nga një investim i mëhershëm i kryer nga prindërit e tij tek firma piramidale “\*\*\*\*”. Në këtë shoqëri, prindërit e tij kanë investuar shumën 1.200.000 lekë, me burim nga shitja e një apartamenti, sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., datë 11.11.1994. Subjekti ka bërë me dije se prindërit e tij e kanë investuar këtë shumë në dhjetor të vitit 1994 tek shoqëria “\*\*\*\*” deri në qershor të vitit 1996, duke paraqitur një tabelë përlllogaritjeje të interesave të akumuluarra deri në momentin e tërheqjes, prej rreth 6.000.000 lekë. Ndërkohë, MFE-ja, shoqëritë huamarrëse në administrim, ka informuar se znj. H. ka qenë kreditore pranë shoqërisë “\*\*\*\*”, në të cilën ka rezultuar se ka investuar shumën 11.000.000 lekë dhe ka tërhequr shumën 11.132.000 lekë, por nuk ka të dhëna lidhur me momentin e depozitimit apo të tërheqjes së tyre. Subjekti ka bërë me dije se nga 11.132.000 lekë të tërhequra, rreth 7.000.000 lekë kanë qenë të prindërve (nga të cilët 2.500.000 lekë janë përdorur për blerjen e një apartamenti,

---

<sup>19</sup> ASHK Vlorë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2022, ka informuar se në emër të prindërve të subjektit kanë qenë të regjistruara pasuritë në vijim: pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e përfituar me kontratën e shitjes datë 10.6.1996; pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e përfituar me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.7.2003, të Gjykatës (pasuri kjo e porositur prej tyre në vitin 1994); si dhe pasuri të llojit arë dhe truall të përfituara me anë të trashëgimisë së gjyshërve të subjektit (prindërve të babait).

ndërsa diferenca është investuar tek shoqëria “\*\*\*\*”), ndërsa diferenca ka qenë e miqve dhe e të afërmeve, por nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion për të provuar sa më sipër.

26. Nga sa më sipër – ndonëse nuk është provuar me dokumentacion ligjor vlera monetare e investuar prej prindërve të subjektit tek shoqëria “\*\*\*\*”, pjesa takuese nga shuma e tërhequr prej 11.132.000 lekësh, si dhe momentet e tërheqjes së shumës në fjalë nga kjo shoqëri – këto veprime duket të jenë kryer prej prindërve të subjektit përgjatë periudhës 1994 – 1996, vite në të cilat subjekti i rivlerësimit ka qenë ende në përfundim të shkollës së mesme dhe në fillim të studimeve të larta. Për rrjedhojë, ndonëse nuk është provuar me dokumentacion ligjor burimi i ligjshëm i shumës 4.250.000 lekë, investuar fillimisht në dhjetor 1996 tek shoqëria “\*\*\*\*” nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se kjo nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi këtë të fundit. Për më tepër, duke mbajtur në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit në raport me situata të ngjashme – nisur nga rrethanat e kuadrit ligjor dhe të informalitetit të atyre viteve (’90), si dhe nga specifika e firmave piramidale – do të mjaftonte provueshmëria e ekzistencës së mjeteve monetare dhe tërheqja e tyre nga këto firma (sikurse është rasti konkret) për t’u konsideruar si disponibilitet financiar i poseduesve, pa i penalizuar përdoruesit e këtyre shumave më pas.
  27. Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se nga shuma e marrë hua nga prindërit e tij është shlyer pjesërisht shuma 4.000.000 lekë përgjatë viteve 2012 – 2015, duke deklaruar detyrimin e mbetur ndaj prindërve në masën 3.000.000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se kthimi i kësaj huaje është bërë nëpërmjet BKT-së nga llogaria personale dhe ajo e biznesit të bashkëshortes në llogarinë e nënës dhe se për shlyerjen janë përdorur të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes.
  28. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogaritë bankare ka rezultuar se nga bashkëshortja e subjektit janë transferuar në favor të nënës së subjektit, me qëllim shlyerjen e huas, shumat përkatësisht: 1.500.000 lekë në vitin 2012; 500.000 lekë në vitin 2013; 1.200.000 lekë në vitin 2014; 800.000 lekë në vitin 2015. Nga analiza financiare e viteve 2012 – 2015 ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi për shlyerjet e shumave të mësipërme me burime të ligjshme financiare.
- 1.1.2 Analiza e pagesës së këstit të dytë*
29. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se kësti i dytë prej 30.000 euro është transferuar në datën 7.11.2011 nëpërmjet Tirana Bank nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.
  30. Nga shqyrtimi i historikut të lëvizjeve të llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit ka rezultuar se shuma 30.000 euro ishte transferuar në llogarinë e kësaj të fundit në po të njëjtën datë nga llogaria në euro e personit fizik të saj, gjithashtu konvertuar në datën 7.11.2011 nga gjendja e disponuar në llogarinë në lekë të personit fizik prej 4.045.000 lekësh. Nga analizimi i llogarisë bankare të personit fizik të bashkëshortes së subjektit ka rezultuar se shuma e mësipërme është krijuar ndër vite, përkatësisht nga transfertat nga DRSKSH-ja nga rimbursimet e barnave, si dhe nga disa depozitime të kryera *cash* në këtë llogari nga bashkëshortja e subjektit, me përshkrimin “Kursime familjare”.
  31. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, mes të tjerash, subjekti ka shpjeguar se burimi i krijimit të kësaj shume kanë qenë kursimet familjare ndër vite, siç është deklaruar në deklaratën *Vetting* – ndonëse në detajimin e bërë prej tij të pagesave në këtë deklaratë ka përmendur

të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes, ai nuk ka pasur për qëllim të përjashtojë të ardhurat nga pagat e tij, përpos të ardhurave të bashkëshortes.

32. DRT Tiranë<sup>20</sup> ka konfirmuar se personi fizik “A. H.”, me NIPT \*\*\*, është regjistruar në datën 1.10.2007, me aktivitet në tregtimin me pakicë të produkteve farmaceutike, duke informuar gjithashtu se ky aktivitet nuk shpërndan dividend<sup>21</sup>, sepse është biznes i vogël me përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar të fitimit.
33. Aktiviteti i bashkëshortes së subjektit ka qenë biznes i vogël, me xhiro 2-8 milionë deri në vitin 2013, kohë gjatë së cilës ka pasur përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar të fitimit dhe ka paguar tatimin e thjeshtuar mbi fitimin në masën 10% të tij, e më pas ka kaluar në biznes të madh, duke u bërë objekt i tatimit të fitimit me shkallën tatimore standarde prej 15% nga viti 2014. Nga informacioni i përcjellë nga DRT Tiranë, si dhe formularët e deklaramit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat, ka rezultuar se personi fizik “A. H.” ndër vite ka realizuar të ardhurat dhe fitimin neto, të paraqitura të detajuara në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 1** – Të ardhurat dhe fitimi neto i aktivitetit të bashkëshortes së subjektit

Viti	Te ardhurat	Shpenzimet	Fitimi bruto	Tatimi mbi te ardhurat	Fitimi neto
2008	6,226,924	5,359,557	867,367	86,737	<b>780,630</b>
2009	7,611,000	6,331,000	1,280,000	128,000	<b>1,152,000</b>
2010	7,360,285	6,464,795	895,490	89,549	<b>805,941</b>
2011	7,349,330	5,919,330	1,430,000	143,000	<b>1,287,000</b>
2012	7,058,442	5,572,089	1,486,353	148,635	<b>1,337,718</b>
2013	15,138,277	13,205,230	1,933,047	198,488	<b>1,734,559</b>
2014	27,981,462	26,202,190	1,779,272	266,891	<b>1,512,381</b>
2015	17,352,547	16,501,453	851,094	127,859	<b>723,235</b>
2016	18,727,709	16,672,044	2,055,665	338,013	<b>1,717,652</b>

34. Nisur nga fakti që përgjatë kësaj periudhe subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, Komisioni ka përllogaritur mundësinë e krijimit të shumë 4.045.000 lekë në mënyrë kumulative prej vitit 2004 deri në momentin e pagesës së kështit të dytë prej 30.000 euro, më 7.11.2011. Në këtë analizë janë konsideruar të ardhurat e subjektit nga punësimi prej vitit 2004, ndërsa të ardhurat e bashkëshortes së tij nga viti 2008, moment ky kur ka filluar bashkëjetesa me subjektin, si dhe shpenzimet përkatëse të familjes përgjatë kësaj periudhe.

**Tabela nr. 2** – Analiza financiare për këstet I dhe II të apartamentit

Te ardhura te subjektit 2004 - tetor 2011	5,061,023
Te ardhura te bashkeshortes 2008 - tetor 2011	3,811,071
Shpenzime jetese 2004 - tetor 2011	- 1,904,732
Shpenzime te tjera te periudhes 2005 - tetor 2011	- 840,974
Investuar ne blerjen e automjetit	- 951,012
Te ardhura nga shitja e automjetit ekzistues	300,000
Hua nga prinderit e subjektit	7,000,000
Gjendje ne llogarite bankare ne nentor 2011	- 509,317
Paguar kestet I&II te apartamentit ne nentor 2011	- 11,478,900
<b>Rezultati deri në nëntor 2011</b>	<b>487,160</b>

<sup>20</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2017, si dhe DPT-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2021.

<sup>21</sup> Bazuar në nenin 5.6 “Vendimi për destinimin e fitimit” të UMF-së nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nuk ka detyrim të depozitohet pranë administratës tatimore vendimin e organit vendimmarrës të shoqërisë për rezultatet financiare dhe destinimin e fitimit pas tatimit.

35. Nga sa më sipër, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të kryer pagesën prej 30.000 euro, në datën 7.11.2011, me burim nga të ardhurat e tyre familjare.

### 1.1.3 Analiza e pagesës së kështit të tretë

36. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se pjesa e kështit të tretë prej 6.000 euro (nga 7.000 euro të mbetura) është depozituar në datën 5.5.2016, nëpërmjet BKT-së, nga bashkëshortja e subjektit në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Referuar deklaramëve të subjektit në DIPP-në e vitit 2016, si dhe në deklaratën *Vetting*, kjo shumë prej 6.000 euro ka pasur si burim huan e marrë nga babai i bashkëshortes, i cili në datën 5.5.2016 ka depozituar shumë 800.000 lekë në llogarinë e znj. A. H.<sup>22</sup>. Subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion ligjor që të konfirmojë marrëdhënien e huas nga babai i bashkëshortes, sipas parashikimeve ligjore të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ai ka paraqitur një vërtetim page të datës 23.1.2017, të lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në të cilin citohet se z. N. K. është punonjës pranë kësaj shoqërie nga viti 2004 e në vijim, me pagë mujore 25.000 lekë.

37. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të babait të bashkëshortes së subjektit nuk ka rezultuar ndonjë tërheqje në atë periudhë e ndonjë shume të përafërt me shumë e huazuar. Për rrjedhojë, Komisioni ka analizuar mundësinë e krijimit të kursimeve në masën e huazuar nga familja e origjinës së bashkëshortes së subjektit, me burime të ligjshme financiare.

38. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se babai i bashkëshortes së subjektit ka tërhequr nga llogaritë e tij të pagës, përgjatë periudhës mars 2011 – maj 2016, shumë 1.220.000 lekë. Ndërsa nëna dhe vëllai i bashkëshortes së subjektit janë trajtuar përkatësisht me pension pleqërie dhe invaliditeti, nga ku kanë përfituar të ardhurat në masën 888.706 lekë<sup>23</sup> dhe 851.009 lekë, duke arritur në një total të të ardhurave familjare për periudhën e analizuar prej 2.959.715 lekësh.

39. Pasi janë përllogaritur edhe shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë ka rezultuar se familja e origjinës së bashkëshortes së subjektit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 595.893 lekësh për të dhënë shumë e pretenduar prej 800.000 lekësh hua subjektit të rivlerësimit.

40. Lidhur me likuidimin e shumë 800.000 lekë, të marrë hua nga prindërit e bashkëshortes së tij, subjekti ka deklaruar se kjo shumë është kthyer *cash* dhe si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes gjatë vitit 2016.

41. Nga analiza financiare e vitit 2016 ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të kthyer pas huan e marrë gjatë vitit 2016, prej -401.740 lekësh, siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim.

<sup>22</sup> Së bashku me dokumentacionin e paraqitur bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur edhe një mandat depozitimi *cash*, datë 5.5.2016, nga vjehëri i tij, z. N. K. , në llogarinë e bashkëshortes së tij në BKT, të shumë prej 800.000 lekësh.

<sup>23</sup> Nga të cilat 796.206 lekë nga pensioni i pleqërisë për periudhën 7.6.2013 – 30.4.2016, si dhe 92.500 lekë të tërhequra në maj 2011, nga pensioni i invaliditetit të akumuluar në llogari deri në atë moment.

**Tabela nr. 3** – Analiza financiare për kthimin e huas tek prindërit e bashkëshortes

Te ardhura te subjektit te vitit 2016	1,178,247
Te ardhura te b/shortes te vitit 2016	1,717,652
Shpenzime jetese te vitit 2016	- 940,368
Blere automjeti ne date 10.9.2016	- 730,458
Shpenzime udhetimi te vitit 2016	- 291,228
Shpenzime qiraje ne Sarande te vitit 2016	- 150,000
Shpenzime arsimimi te femijeve te vitit 2016	- 173,500
Ndryshimi ne gjendjet e llogarive bankare	- 65,195
Paguar kesti fundit i apartamentit (me burim nga kursimet)	- 146,890
Kthyer huaja tek prinderit e b/shortes	- 800,000
<b>Rezultati deri në fund te vitit 2016</b>	<b>- 401,740</b>

42. Lidhur me diferencën e kështit të tretë prej 1.000 euro, subjekti ka shpjeguar se kjo shumë i është likuiduar *cash* shoqërisë shitëse, me burim nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit dhe të bashkëshortes kanë rezultuar tërheqjet e shumave prej 99.500 lekësh nga subjekti në datën 5.5.2016 (me burim nga të ardhurat e tij nga paga) dhe 200.000 lekë nga bashkëshortja në datën 6.5.2016 (me burim nga të ardhurat nga aktiviteti, të transferuara nga llogaria e personit fizik në datën 4.5.2016), të cilat duken të mjaftueshme për pagesën e shumës 1.000 euro *cash* në favor të shoqërisë ndërtuese. Bashkëshortja e subjektit ka tërhequr shumën 831.000 lekë nga llogaria e saj dhe po në të njëjtën datë ka depozituar shumën 6.000 euro në llogarinë e shoqërisë ndërtuese.
43. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova/shpjegime të tjera, për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit, lidhur me sa vijon:
- *Duket se prindërit e bashkëshortes së subjektit kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -595.893 lekësh për t'i dhënë huan prej 800.000 lekësh subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, për kryerjen e pagesës së kështit të tretë për blerjen e apartamentit, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -595.893 lekësh.*
  - *Duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -401.740 lekësh për kthimin e huas së marrë nga prindërit e bashkëshortes.*

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

44. Subjekti ka parashtruar se ndonëse bashkëshortja e tij dispononte shumën 619.570 lekë në llogarinë e saj personale në BKT, kjo shumë nuk mund të përdorej, pasi asaj i nevojitej gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar për likuidimin e furnitorëve. Në këto kushte, me kërkesën e znj. A. H., babai i ka depozituar shumën 800.000 lekë në llogarinë e saj. Marrëdhënia financiare në fjalë është konfirmuar nga vjehrra e subjektit, znj. M. K., nëpërmjet një deklarate të datës 2.10.2023, pasi vjehrra e subjektit ka ndërruar jetë.
45. Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së huas, subjekti ka parashtruar se familja K. gjatë periudhës mars 2011 – prill 2016 ka pasur dhe të ardhura të tjera, veç atyre të marra në analizë nga Komisioni. Konkretisht, vjehrra e subjektit, znj. M. K. ka

pasur të ardhura nga pensioni i invaliditetit<sup>24</sup>, të ardhura nga pensioni i pleqërisë<sup>25</sup>, si dhe një pagesë ndihmë nga Bashkia Kuçovë në shumën 2.200 lekë/muaj, përmes Raiffeisen Bank. Sipas subjektit, të ardhurat në total të znj. M. K. për periudhën mars 2011 – prill 2016 kanë qenë në shumën 1.434.570 lekë.

46. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se edhe vëllai i bashkëshortes së tij, z. A. K., për periudhën 2011 – 2015 është trajtuar me pension invaliditeti<sup>26</sup>, për të cilin disponon dokumentacion ligjor vetëm për periudhën shtator 2015 – 2023. Subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2023, nga Njësia Administrative \*\*\*, Tiranë, në të cilin citohet se të ardhurat e z. K. kanë qenë në masën 3.300 lekë/muaj. Subjekti ka parashtruar se për periudhën në analizë të ardhurat shtohen me 26.400 lekë, duke arritur në shumën totale prej 877.409 lekësh.
47. Në këtë llogari, për periudhën mars 2011 – gusht 2013, znj. K. ka tërhequr shumën 90.500 lekë, të përfituar nga ndihma ekonomike e bashkisë.
48. Subjekti ka parashtruar se veç të ardhurave të mësipërme, familja ka pasur edhe të ardhura nga punësimi i shtetasit A. K. (pjesëtar i familjes, sipas certifikatës familjare të periudhës në analizë), i cili deri në vitin 2014 ka jetuar me prindërit. Subjekti ka paraqitur një vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i gjeneruar nga e-Albania, sipas të cilit të ardhurat neto të shtetasit A. K. kanë qenë në shumën 801.139 lekë.
49. Subjekti ka përllogaritur edhe shpenzimet e jetesës së familjes së bashkëshortes deri në vitin 2014 për 4 persona dhe periudhën janar 2015 – prill 2016 për 3 persona, në referencë të shkresës nr. \*\*\*, datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së. Sipas tij, për periudhën mars 2011 – prill 2016, shpenzimet e jetesës kanë rezultuar në shumën 3.371.504 lekë.
50. Në total, rezultati vetëm për periudhën mars 2011 – prill 2016 është 151.614 lekë, që sipas subjektit do të thotë se familja K. ka pasur mundësi që të jepte hua këtë shumë, pa marrë parasysh këtu që familja në përgjithësi ka pasur gjendje *cash* edhe para kësaj periudhe.
51. Lidhur me kthimin e huas prindërve të bashkëshortes së tij, subjekti ka sqaruar se gjatë muajit maj të vitit 2016 është likuiduar shuma 290.000 lekë nga llogaria e aktivitetit të bashkëshortes. Ndërsa në muajin qershor të të njëjtit vit, subjekti ka deklaruar se ai dhe bashkëshortja i kanë kthyer prindërve të bashkëshortes shumën 300.000 lekë (200.000 lekë, tërhequr nga banka dhe 100.000 nga të ardhurat nga shitjet me kasë). Pjesa e mbetur prej 200.000 lekësh është kthyer gjatë periudhës tetor – dhjetor 2016, herë duke tërhequr nga llogaria bankare, herë nga shitja me kasë, plotësuar edhe nga të ardhurat e pagës së subjektit.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

52. Lidhur me marrëdhënien e huas (mes bashkëshortes së subjektit dhe babait të saj), pavarësisht se nga hetimi nuk rezultoi e formalizuar me dokumentacion të kohës, Komisioni çmon se kjo është një kontratë e lidhur midis palëve në një marrëdhënie të posaçme. Në të tilla kushte vlerësohet se gjen zbatim neni 233, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se një nga rastet e lejimit të marrjes së provës me

<sup>24</sup> Subjekti ka paraqitur një vërtetim për pension invaliditeti me nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2021, nga Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për periudhën 2011 – 2013.

<sup>25</sup> Subjekti ka paraqitur një vërtetim për pension pleqërie me nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, nga Drejtoria Rajonale e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për periudhën 2011 – 2013.

<sup>26</sup> Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës shkresën nr. \*\*\*, datë 27.7.2021, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

dëshmitarë është ai kur “[...] ç) për shkak të rrethanave në të cilat është kryer veprimi juridik ose të marrëdhënieve të posaçme të palëve, nuk ka qenë e mundur të merrej prova me shkresë”.

53. Në këto kushte, bashkekzistenca e dy elementeve, konkretisht, marrëdhënia e posaçme (lidhja familjare prind – fëmijë) dhe mungesa e aktit të shkruar, kornizon sferën e veprimit sipas përcaktimeve të dispozitës së sipërcituar. Në përforcim të këtij argumenti vjen edhe fakti i rezultuar nga hetimi se huaja është administruar nga bashkëshortja e subjektit përmes bankës, çka, ndonëse në pamje të parë jo detyrimisht legjitimon burimin, por së paku e bën lehtësisht të dokumentueshëm momentin kohor të këtij transaksioni, në funksion të përlllogaritjes së mundësisë financiare të huadhënësit.
54. Gjithashtu, fakti që, nga njëra anë personi tjetër i lidhur (huadhënësi) ndërkohë ka ndërruar jetë dhe, nga ana tjetër, subjekti është treguar aktiv dhe bashkëpunues gjatë procesit, duke vënë në dispozicion deklaratën noteriale të vjehrrës së tij (e cila konfirmon marrëdhënien e huas në analizë), si dhe dokumentacionin që provon të ardhurat e familjes së të ndjerit, çmohet se nga sa më sipër përmbushet kriteri i konfirmimit të kësaj marrëdhënieje, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
55. Lidhur me aftësinë financiare të prindërve të bashkëshortes së subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua vajzës së tyre, Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – vlerëson se subjekti, nëpërmjet prapësimeve dhe dokumentacionit mbështetës që ka paraqitur, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, ka arritur të provojë mjaftueshmërinë e burimeve financiare lidhur me këtë huadhënie, sikurse arsyetohet në vijim.
56. Për efekt të verifikimit të burimeve të ligjshme për huan e deklaruar si burim për pagesën e këstit të tretë të apartamentit në pronësi të subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë parashikimin e nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit<sup>27</sup>, në drejtim të kufijve të hetimit mbi burimet e ligjshme të personave të tjerë të lidhur, vlerëson që të konsiderojë në analizën financiare të ardhurat dhe shpenzimet jo vetëm për prindërit e bashkëshortes, por për të gjithë anëtarët e familjes së tyre ndër vite, sipas përbërjes së saj.
57. Në këtë kuptim, bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit, për të provuar ligjshmërinë e shumës së dhënë hua nuk do të ishte realiste dhe e arsyeshme një analizë e kryer vetëm për personin tjetër të lidhur (vjehrrin), pa verifikuar e konsideruar të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet jetike për të gjithë anëtarët e familjes. Kësisoj, mund të vlerësohet nëse të ardhurat dhe ekonomia familjare e tij (huadhënësit) i ka mundësuar ose jo një mjaftueshmëri financiare për të mbuluar së pari kostot e jetesës për të gjithë anëtarët e familjes dhe pastaj për të parë nëse do të mbetej një disponibilitet financiar për huadhënien e shumës përkatëse. Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga dispozita e mësipërme lidhur me burimet shtesë të të ardhurave – të paraqitura nga subjekti pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ –

<sup>27</sup> Shihni vendimin E. Toro nr. 2, datë 2.2.2023, pg. 18.8.

Komisioni çmon që t'i marrë ato në konsideratë në masën që ka kaluar testin e provueshmërisë së dokumentacionit të administruar në raport me burimet financiare të pretenduara.

58. Në bazë të dokumentacionit ligjor, duke u nisur nga përmbajtja e rezultateve të njoftuara në raport me të ardhurat shtesë të pretenduara nga subjekti, ka rezultuar se këto të ardhura justifikojnë me burim të ligjshëm huadhënien në shumën 800.000 lekë, siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim<sup>28</sup>.

**Tabela nr. 4** – Analiza financiare për dhënien e huas nga prindërit e bashkëshortes

	Në rezultate	Pas prapësimeve
Të ardhura të z. N. K. mars 2011 - prill 2016	1,220,000	1,220,000
Të ardhura të z. And. K. mars 2011 - prill 2016	851,009	877,409
Të ardhura të z. Art. K. 2013 - 2014		801,139
Të ardhura të zj. M. K. mars 2011 - prill 2014	888,706	1,434,570
Shpenzime jetese mars 2011 - prill 2016	- 2,755,608	- 3,371,504
Hua vajzës, datë 5.5.2016	- 800,000	- 800,000
<b>Rezultati</b>	<b>- 595,893</b>	<b>161,614</b>

## 2. Automjet tip “Volkswagen Golf”, në vlerën 5.400 euro

59. Në DIPP-në e vitit 2016, si dhe në deklaratën *Vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar pasurinë e llojit automjet tip “Volkswagen Golf”, me targë \*\*\*, të blerë me anë të kontratës nr. \*\*, datë 13.9.2016, kundrejt çmimit 5.400 euro, i cili referuar kontratës është likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale, në datën 10.9.2016.
60. Burimi i krijimit është deklaruar me të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm me targë \*\*\*, në shumën 570.000 lekë, të shitur me anë të kontratës nr. \*\*, datë 5.9.2016, ndërsa pjesa tjetër me të ardhurat nga fitimet e aktivitetit gjatë vitit 2016.
61. AMF-ja<sup>29</sup> ka konfirmuar informacionin dhe kontratat e sipërcituara.
62. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2021, ka bërë me dije se nga verifikimet në sistemin informatik ka rezultuar se në emër të subjektit dhe bashkëshortes figurojnë përkatësisht mjetet me targa \*\*\* dhe \*\*\*, duke paraqitur dokumentacionin lidhur me këto dy mjete<sup>30</sup>.
63. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e automjetit me targë \*\*\* ka rezultuar se është blerë fillimisht nga subjekti i rivlerësimit në shtetin italian me anë të deklaratës për shitje të datës 10.9.2010, kundrejt çmimit 5.000 euro, si dhe është zhdoganuar nga subjekti kundrejt pagesës së tarifës doganore prej 256.962 lekësh. Këtë automjet subjekti i rivlerësimit ia ka shitur aktivitetit të bashkëshortes së tij, person fizik “A. H.”, me anë të kontratës nr. \*\*, datë 22.4.2014, kundrejt çmimit 8.000 euro.
64. I pyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se çmimi i aplikuar në shitjen e mjetit prej 8.000 euro reflekton shpenzimet e kryera për riparimin e mjetit, të cilat kanë qenë në vlera të konsiderueshme<sup>31</sup>. Në vijim të sa më sipër,

<sup>28</sup> Të ardhurat e shtetasit A. K. janë përlogaritur sipas shpjegimeve të subjektit për periudhën mars 2011 – dhjetor 2014.

<sup>29</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2021 dhe RNSH me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2021.

<sup>30</sup> Pas kontrollit në sistemin TIMS për hyrje-daljet e subjektit dhe anëtarëve të familjes së tij, Komisioni ka verifikuar targat e automjeteve me të cilat kanë udhëtuar, nga ku nuk ka rezultuar ndonjë problematikë.

<sup>31</sup> Komisioni ka konsideruar të kryer një shpenzim prej 1.000 euro/vit për vitet 2011 – 2013.



ka rezultuar se nga njëra anë ka mungesë të logjikës së shitjes së një automjeti me fitim brenda anëtarëve të familjes (kjo pasi referuar edhe udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, personi fizik tregtar nuk ka personalitet juridik të ndryshëm nga individi), ku ekonomia është e përbashkët dhe, rrjedhimisht, si shpenzimet dhe të ardhurat janë të përbashkëta dhe, nga ana tjetër, subjekti nuk ka provuar me dokumentacion shpenzimet e pretenduara si të kryera për riparimin e mjetit, të cilat sipas saj kanë qenë në vlera të konsiderueshme. Për rrjedhojë, në analizën financiare të vitit 2014, nga Komisioni janë konsideruar të ardhurat nga shitja në masën 951.012 lekë (e barabartë kjo me çmimin e blerjes në vitin 2010 dhe tarifën e zhdoganimit të paguar për mjetin), ndërsa investimi nga bashkëshortja në shumën 1.120.880 lekë (e barabartë me çmimin e blerjes nga personi fizik, bashkëshortja).

65. Në vijim, ky automjet është shitur nga personi fizik “A. H.”, kundrejt çmimit 570.000 lekë, çmim ky që është më i ulët edhe se çmimi fillestar i blerjes prej subjektit, nga ku ka rezultuar se nuk do të kishte problematika lidhur me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Por, nga analizimi i lëvizjeve bankare ka rezultuar se pala blerëse E. S. ka transferuar në favor të bashkëshortes së subjektit shumën 570.000 lekë, me përshkrimin “Për blerje automjeti”, shumë të cilën kjo e fundit e ka kaluar tek llogaria e personit fizik dhe nuk është tërhequr më prej saj, së paku deri në datën e blerjes së automjetit të ri. Për rrjedhojë, ka rezultuar se kjo shumë nuk mund të kishte shërbyer si burim për blerjen e automjetit në analizë.
66. Komisioni ka analizuar mundësinë për blerjen e automjetit në analizë me kursimet e mundshme për t’u krijuar deri në datën e kryerjes së pagesës së çmimit të blerjes, e cila referuar kontratës së shitblerjes është paguar në datën 10.9.2016<sup>32</sup>, nga ku ka rezultuar se subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -563.269 lekësh.
67. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur prova/shpjegime të tjera lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme financiare prej -563.269 lekësh.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

68. Subjekti ka parashtruar se si burim për krijimin e pasurisë automjet tip “Volkswagen Golf” kanë shërbyer të ardhurat në shumën 500.000 lekë nga aktiviteti tregtar që ushtronte bashkëshortja e tij, të tërhequra nga llogaria e personit fizik në datën 1.9.2016, si dhe shuma prej 230.000 lekësh, e akumuluar nga shitjet me kasë në korrik në vlerën 679.169 lekë; në gusht në vlerën 797.124 lekë, si dhe në shtator në vlerën 1.012.430 lekë. Në mbështetje të deklaratimit të tij, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës ekstraktin e llogarisë bankare të personit fizik “A. H.”, si dhe librat e shitjes për muajt korrik, gusht e shtator 2016.
69. Subjekti ka deklaruar se duke qenë se automjeti që ai dhe bashkëshortja kanë pasur në pronësi ka qenë i regjistruar në emër të biznesit të bashkëshortes, ishin të detyruar që të ardhurat nga shitja e tij të kalonin në llogarinë e këtij biznesi. Likuiditetet e llogarisë së biznesit janë përdorur edhe për nevojat familjare, sikurse ka ndodhur edhe me të ardhurat

<sup>32</sup> Në këtë analizë janë konsideruar të ardhurat dhe shpenzimet deri në datën e blerjes 10.9.2016. Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes, Komisioni ka konsideruar të ardhurat në mënyrë përpjesëtimore, në raport me fitimin total të vitit (në të cilin është e përfshirë edhe e ardhura nga shitja e mjetit) dhe ndryshimi në gjendjet e llogarive bankare të personit fizik (në të cilat ka mbetur pa tërhequr të ardhurat nga shitja e mjetit dhe, për rrjedhojë, nuk ka qenë e mundshme për t’u përdorur për investimin e ri të kryer).

nga paga e subjektit që janë përdorur në funksion të këtij biznesi për të kryer likuidime faturash<sup>33</sup>. Subjekti ka pretenduar se ndryshimi i gjendjes së llogarisë në bankë nuk duhet të konsiderohej në analizë, pasi është ndryshimi i llogarisë së biznesit dhe jo i llogarive personale të tij dhe bashkëshortes. Ndryshimi i gjendjeve të llogarive të biznesit është paraqitur në bilancin e vitit 2016.

### Vlerësimi i trupit gjykues

70. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe pas analizimit të prapësimeve të tij, Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së (si deklaratat periodike, edhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja); (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet e tij pas njoftimit të rezultateve (konkretisht dokumenti bankar ku pasqyrohet tërheqja e shumës 500.000, për sa kohë nga hetimi nuk rezultoi që kjo shumë të jetë përdorur nga subjekti për kryerjen e ndonjë investimi tjetër) – vlerëson se të ardhurat e realizuara nga personi fizik “A. H.” kanë qenë të mjaftueshme për mundësimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë së llojit automjet, në vlerën 5.400 euro, likuiduar në datën 10.9.2016.
71. Në këto kushte, duke vlerësuar se ky burim të ardhurash kënaq kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, Komisioni ka përlllogaritur të ardhurat e ligjshme të përdorura nga subjekti për krijimin e kësaj pasurie në raport me shumën e shpenzuara dhe shpenzimet jetike, kësajsoj, pas prapësimeve të subjektit, ka rezultuar një pamjaftueshmëri minimaliste prej 63.296 lekësh – siç është paraqitur në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 5** – Analiza financiare për blerjen e automjetit (pas prapësimeve)

	Në rezultate	Pas prapësimeve
Të ardhurat e subjektit 1.1.2016 - 10.9.2016	778,500	778,500
Të ardhurat e b/shortes 1.1.2016 - 10.9.2016	1,192,337	1,192,337
Të ardhura nga rimbursimet FSDKSH		500,000
Shpenzime jetese 1.1.2016 - 10.9.2016	- 652,772	- 652,772
Shpenzime qiraje 1.1.2016 - 10.9.2016	- 105,000	- 105,000
Shpenzime arsimimi të fëmijëve të vitit 2016	- 173,500	- 173,500
Shpenzime udhëtimi 1.1.2016 - 10.9.2016	- 155,958	- 155,958
Paguar kësti fundit i apartamentit (me burim nga kursimet)	- 146,890	- 146,890
Ndryshimi në gjendjet e llogarive bankare	- 569,528	- 569,528
Paguar cmimi automjeti në datë 10.9.2016	- 730,458	- 730,458
<b>Rezultati</b>	<b>- 563,269</b>	<b>- 63,269</b>

72. Në përfundim, trupi gjykues, duke konsideruar volumin e shitjeve dhe llojin e aktivitetit si person fizik, vlerëson se gjendemi përballë një konfuzioni (fiziologjik) mes të ardhurave nga aktiviteti dhe administrimi e përdorimi i tyre jo vetëm në funksion të aktivitetit, por edhe për nevojat e familjes/individit. Kësajsoj, posedimi dhe përdorimi i shumave apo të ardhurave të krijuara nga ky aktivitet shpeshherë marrin formën e likuiditeteve të vëna në shërbim të nevojave familjare e anasjelltas, pa qenë nevoja e pasqyrit të tyre formalisht në dokumentet e aktivitetit të personit fizik me një likuiditet dinamik dhe fluid.

<sup>33</sup> Shihni *statement*-in e Credins Bank, llogaria personale datë 6.9.2016.

73. Lidhur me diferencën e rezultuar në vlerën 63.269 lekë, Komisioni çmon se bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe duke mbajtur në konsideratë masën e kësaj pamjaftueshmërie, ajo nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, nuk mund të përbëjë një shkak për vendosjen e masës disiplinore “Shkarkimi nga detyra”.

### **3. Lidhur me një llogari bankare pranë Raiffeisen Bank dhe një tjetër llogarie bankare pranë Credins Bank (të dyja) në emër të subjektit**

74. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjet e llogarive të tij, përkatësisht, në Raiffeisen Bank me gjendje 48,32 lekë dhe në Credins Bank me gjendje 369,8 lekë.

75. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të subjektit ka rezultuar se përputhen gjendjet e deklaruara prej subjektit me ato të rezultuara nga dokumentacioni i administruar. Gjithashtu, është konfirmuar burimi i këtyre shumave të mbetura nga të ardhurat nga pagat, kredituar në to.

76. Në përfundim të sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarimin e llogarive bankare të subjektit dhe burimin e krijimit të gjendjeve monetare përkatëse.

### **4. Llogari kursimi në emër të vajzës së subjektit, në BKT**

77. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një llogari bankare të çelur në emër të vajzës K. H. nga bashkëshortja e tij në BKT dhe që kreditohej automatikisht nga llogaria e biznesit të bashkëshortes, me gjendje 153.954 lekë.

78. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogarinë bankare të mësipërme ka rezultuar se përputhet gjendja e deklaruar prej subjektit me çka ka rezultuar nga dokumentacioni i administruar. Gjithashtu është konfirmuar çelja e llogarisë nga bashkëshortja e subjektit, duke u depozituar fillimisht një shumë prej 50.000 lekësh në momentin e çeljes dhe, më tej, e kredituar me vlerën 10.000 lekë/muaj nga llogaria e personit fizik “A. H.”.

79. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarimin e llogarive bankare të subjektit dhe burimin e krijimit të tyre.

### **5. Lidhur me një llogari bankare në emër të bashkëshortes së subjektit (si individ) në Credins Bank, si dhe një llogari bankare në emër të aktivitetit të bashkëshortes në po të njëjtën bankë**

80. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar gjendjet e llogarive të saj në Credins Bank, përkatësisht atë individuale me gjendje 5.715 lekë dhe atë të personit fizik me gjendje 293 lekë.

81. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të subjektit ka rezultuar se përputhen gjendjet e deklaruara prej subjektit me çka ka rezultuar nga dokumentacioni i administruar. Gjithashtu, është konfirmuar burimi i këtyre shumave të mbetura nga kreditime nga llogaria e personit fizik apo nga llogaria e subjektit, me burim nga të ardhurat nga pagat e këtij të fundit apo nga të ardhurat nga aktiviteti.

82. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika lidhur me deklarimin e llogarive bankare të subjektit dhe burimin e krijimit të tyre.

## REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

83. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit ndër vite, pas përlogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në tabelën që i bashkëngjitet këtij dokumenti janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
84. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2004<sup>34</sup>, vit në të cilin fillon deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI deri në vitin 2016, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën -997.633 lekë.
85. Në vijim të analizimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, paraqitur në prapësimet e dërguara prej tij, ka rezultuar një balancë negative e përgjithshme në masën -401.740 lekë, siç është detajuar në tabelën vijuese.

### Analiza financiare për periudhën 2004 – 2016

	2004 - 2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>3,744,798</b>	<b>9,006,752</b>	<b>-423,017</b>	<b>90,251</b>	<b>873,759</b>	<b>97,144</b>	<b>1,742,543</b>
Apartament banimi në Tiranë		11,478,900					946,890
Automjet VW Golf							730,458
Automjet Mercedes Benz (kaluar tek PF)	694,050				1,120,880		
Ndryshim likuiditeti	3,050,748	-2,472,148	-423,017	90,251	-247,121	97,144	65,195
<b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>	<b>3,050,748</b>	<b>578,600</b>	<b>155,584</b>	<b>245,834</b>	<b>-1,287</b>	<b>95,858</b>	<b>161,053</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>7,000,000</b>	<b>-1,500,000</b>	<b>-500,000</b>	<b>-1,200,000</b>	<b>-800,000</b>	<b>0</b>
Hua nga prindërit		7,000,000					
Hua nga prindërit e b/shortes							800,000
Shlyer hua ndaj prinderve/prinderve te b/shortes			-1,500,000	-500,000	-1,200,000	-800,000	-800,000
<b>PASURI NETO</b>	<b>3,744,798</b>	<b>2,006,752</b>	<b>1,076,983</b>	<b>590,251</b>	<b>2,073,759</b>	<b>897,144</b>	<b>1,742,543</b>
<b>Të ARDHURA te dokumentuara</b>	<b>7,400,479</b>	<b>3,352,399</b>	<b>2,464,026</b>	<b>2,574,232</b>	<b>4,693,031</b>	<b>3,091,511</b>	<b>2,895,899</b>
Të ardhura të subjektit	4,361,908	781,398	722,158	755,987	879,279	912,596	1,178,247
Të ardhura nga aktiviteti bashkëshortes	2,738,571	1,287,000	1,337,718	1,734,559	1,512,381	723,235	1,717,652
Të ardhura nga DRSSH					142,576		
Të ardhura nga shitja e automjetit	300,000				951,012		
Kursime te mbartura nga viti meparshem	0	1,284,001	404,150	83,686	1,207,783	1,455,680	
<b>SHPENZIME</b>	<b>2,371,680</b>	<b>941,496</b>	<b>1,303,357</b>	<b>776,198</b>	<b>1,163,592</b>	<b>1,357,140</b>	<b>1,555,096</b>
Shpenzime jetese	1,563,182	409,860	423,072	458,328	879,992	897,104	940,368
Shpenzime arsimi					173,500	173,500	173,500
Shpenzime qiraje	165,000	180,000	30,000				150,000
Shpenzime udhëtimi/transporti	358,113	212,736	115,965	83,160	13,050	270,096	291,228
Shpenzime mobilimi			580,000	90,000	80,000		
Shpenzim per zhdoganim automjeti	256,962						
Shpenzim për siguracion automjeti	28,424	600	14,600	4,500	17,050	16,440	0
Shpenzim per riparim automjeti		138,300	139,720	140,210			
Analiza dokumentuar	1,284,001	404,150	83,686	1,207,783	1,455,680	837,227	-401,740

<sup>34</sup> Subjekti ka plotësuar edhe DIPP-në e vitit 2003, ndonëse ai ka nisur detyrën si oficer i policisë gjyqësore në datën 1.1.2004, për shkak se kjo DIPP është plotësuar nga z. Hysenaj në datën 23.3.2004.

86. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se z. Elidon Hysenaj ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm burimin financiar për të gjitha pasuritë e analizuara më sipër.
87. Ndërkohë që, pas analizës financiare të përditësuar, mungesa e likuiditeteve (balanca negative) prej -401.740 lekësh në vitin 2016, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit, si dhe duke mbajtur në konsideratë masën e kësaj pamjaftueshmërie, çmohet se ajo nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, nuk mund të përbëjë një shkak për vendosjen e masës disiplinore “Shkarkimi nga detyra”.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

88. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit një raport për subjektin e rivlerësimit, z. Elidon Hysenaj, me nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017 – i përpiluar pa përgjigjen e njërit prej organeve ligjzbatuese – me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës.
89. Më tej, me shkresat e datave 2.7.2018 (nr. \*\*\* prot.) dhe 4.7.2022 (nr. \*\*\* prot.) AKSIK-ja i ka bërë me dije Komisionit se nëpërmjet përgjigjeve dhe komunikimeve me organet ligjzbatuese, me shkresën e datës 15.5.2018 e në vijim është njoftuar prezenca e të dhënave lidhur me dyshime se subjekti Elidon Hysenaj ka favorizuar disa persona, përgjatë kryerjes së funksionit të tij si prokuror nëpërmjet mitmarrjes, duke u përfshirë në veprimtari të kundërligjshme si korrupsion pasiv dhe shpërdorim detyre. Lidhur me këto dyshime, Komisioni ka kryer verifikimet dhe vlerësimet, siç përshkruhen në vijim.
90. Gjithashtu, me shkresën e datës 30.11.2022, AKSIK-ja i ka përcjellë Komisionit një raport të dytë, të datës 13.10.2022, ku ka ndryshuar konstatimin fillestar nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vijimin e detyrës për subjektin Elidon Hysenaj. Ky raport me nr. \*\*\* prot. është deklasifikuar pjesërisht në datën 18.11.2022, me vendimin nr. \*\*\* të KDZH-së.
91. Në vijim dhe vlerësim të të dhënave që disponoheshin lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, nisur nga informacionet e përcjella nga organet ligjzbatuese dhe pasi janë aksesuar informacionet e klasifikuara pranë organit kompetent, në përputhje me nenin 41, paragrafi 4 i ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një hetim administrativ gjithëpërfshirës, duke kërkuar informacione dhe dokumentacione shtesë. Gjithashtu janë administruar dhe analizuar disa akte, vendime e dosje, që lidheshin me çështjet penale, me qëllim verifikimin e të dhënave të raportuara të bëra me dije edhe nëpërmjet aksesimit të dokumenteve e informacioneve të klasifikuara, që lidheshin me kriterin e figurës.
92. Nisur nga sa më sipër, Komisioni, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 14.6.2023, iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.7.2023, ka përcjellë dokumentacionin, nga i cili, pasi është shqyrtuar dhe analizuar, ka rezultuar sa vijon:

**i. Në lidhje me çështjen penale me të dyshuar shtetasit F. G. dhe K. H., të akuzuar për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, pas kërkesës së Komisioni, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë<sup>35</sup> vuri në dispozicion dokumentacionin përkatës.**

93. Nga analizimi i vendimit të datës 6.8.2018, me objekt “Vleftësimi i ligjshëm i arrestimit dhe caktimi i masës së sigurimit “Arrest në burg””, subjekti i rivlerësimit brenda afatit 48 orë të përcaktuar nga Kodi i Procedurës Penale ka kërkuar në ngarkim të të dyshuarve F. G. dhe K. H. vleftësimin e ligjshëm të arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest me burg”<sup>36</sup>, kërkesë që është pranuar nga Gjykata me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.8.2018. Ky vendim është ankimuar vetëm nga shtetasi K. H. dhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka vendosur “Miratimin e vendimit penal”, ndërsa për shtetasin F. G. vendimi ka marrë formë të prerë.
94. Në datën 6.9.2019, shtetasi F. G. ka paraqitur kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” në “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” ose “Garanci pasurore”. Në kërkesën e depozituar nga organi i akuzës për zëvendësimin e masës së sigurisë, bazuar në nenet 246/6 dhe 260/1 të Kodit të Procedurës Penale, është arsyetuar dhe argumentuar nga subjekti i rivlerësimit se për shtetasin F. G. tashmë kishin ndryshuar dhe ishin zbutur kushtet që ekzistonin më parë kur ajo ishte vendosur, bazuar kjo në dokumentacionin, deklaratën personale të babait të shtetasit F. G. lidhur me vlerën monetare të sekuestruar gjatë momentit të arrestimit në flagrancë të këtij shtetasi, shoqëruar kjo me ekstraktin e personit fizik, si dhe pas përfundimit të arritur në aktin e ekspertimit rezultoi se nuk ishin gjetur gjurmë papilare të gishtërinjve të tij në ambalazhin e lëndës së dyshuar narkotike, të vlefshme për identifikim e tij<sup>37</sup>. Kërkesa e subjektit të rivlerësimit është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.9.2018, duke vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” në “Garanci pasurore” në shumën 300.000 lekë, vendim ky që ka marrë formë të prerë.
95. Lidhur me sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të japë shpjegime lidhur me ndryshimin e masës së sigurimit në çështjen e sipërpërkshuar.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

96. Subjekti ka parashtruar se në momentin e paraqitjes së kërkesës nga shtetasi F. G., për zëvendësimin e masës së sigurimit, ishte administruar akti i ekspertimit vlerësues nr. \*\*\*, datë 14.8.2018. Nga ky akt ka nuk kanë rezultuar të dhëna që implikonin shtetasin F. G. si bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale për të cilën dyshohej.
97. Tashmë nuk ekzistonte më dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasi në fjalë e kishte kryer veprën penale për të cilën ishte arrestuar dhe masa e caktuar nuk i përgjigjej më rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikonte vepra penale konkrete. Subjekti ka

<sup>35</sup> Gjykata vuri në dispozicion vendimin për vleftësimin e arrestimit dhe caktimit të masës së sigurimit nr. \*\*\*, datë 6.8.2018, procesverbalin e datës 6.8.2018, CD-në, vendimin nr. \*\*\*, datë 6.9.2018, për zëvendësimin e masës së sigurisë, procesverbalin e datës 6.9.2018, CD.

<sup>36</sup> Në datën 5.8.2018, forcat e policisë kanë ndaluar shtetasit K. H dhe F. G., të cilëve gjatë kontrollit u është gjetur lëndë narkotike dhe një shumë monetare. Për shkak të ndalimit në gjendje flagrante, Prokuroria ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, duke parashtruar në seancë gjyqësore edhe përshtatshmërinë dhe rëndësinë e kësaj mase sigurimi. Avokatët mbrojtës kanë kërkuar si masë sigurimi caktimin e garancisë pasurore të të dyshuarve, e cila fillimisht nuk është pranuar nga Gjykata, në kushtet ku ndodheshin hetimet, pasi ende në atë seancë nuk ishin paraqitur disa prej akteve të ekspertimit.

<sup>37</sup> Sipas aktit të ekspertimit ka rezultuar se shtetasi F. G. nuk ka pasur gjurmë papilare në qeskën ku u gjetën lëndët narkotike, akt ky që në momentin e vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masës “Arrest në burg” ende nuk kishte përfunduar.

shpjeguar se kjo masë ishte e përshtatshme, në përputhje me rastin dhe me nenin 236 të Kodit të Procedurës Penale, për sa kohë nuk ekzistonte më rreziku i ikjes së tij.

98. Subjekti ka parashtruar se duke marrë në konsideratë sa më sipër, kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit duhej të pranohej. Masa e sigurimit “Garanci pasurore” i përshtatej edhe veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, e parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, për të cilën u akuzua më pas i pandehuri – dhe që me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, u deklarua fajtor.
99. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentacionin ligjor përkatës<sup>38</sup>.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

100. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti dhe analizoi prapësimet e tij, vlerëson se çështja në analizë lidhet kryesisht me zbatimin e nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në analizë të dispozitave për revokimin, zëvendësimin apo shuarjen e masave të sigurimit personal në raport me faktin konkret dhe rëndësinë e tij, ka rezultuar se subjekti në momentin e ndryshimit ka evidentuar ekzistencën e rrethanave të ndryshme/ndryshuara nga ato që ishin konstatuar në momentin e caktimit të masës fillestare të sigurimit. Përpos këtij fakti, duke qenë se hetimet ishin pothuajse në fazën përmbyllëse të tyre dhe zëvendësimi i masës së sigurimit nuk mund të ndikonte në procesin e sigurimit të provave, kështu ndryshimi i masës së sigurimit nuk mund të dëmtojte hetimet dhe zbulimin e së vërtetës.
101. Në optikën e nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale nevojat për caktimin e masës së sigurimit janë dinamike. Për rrjedhojë, kur vlerësohet se ka ndryshim të këtyre nevojave, masat e sigurimit mund të revokohen nga gjykata apo të zëvendësohen me një masë më të lehtë, apo më të rëndë, në përputhje me përcaktimet e kësaj dispozite.
102. Në mbështetje të këtij arsytimi vjen edhe fakti se kërkesa e Prokurorisë për zëvendësimin e masës është gjetur e drejtë, e argumentuar dhe e bazuar në nenin 260 të Kodit të Procedurës Penale edhe nga gjykata, e cila ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse subjekti i rivlerësimit, duke disponuar për pranimin e kërkesës së personit nën hetim. Me vendimin penal nr. \*\*\*, datë 6.9.2018, gjykata ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit personal për të arrestuarin F. G. nga “Arrest në burg”, caktuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.8.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në “Garanci pasurore”, të parashikuar nga neni 236 i Kodit të Procedurës Penale, në shumën 300.000 lekë.
103. Trupi gjykues, në mbështetje edhe të praktikës së unifikuar të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>39</sup>, çmon se lehtësimi apo rëndimi i masës së sigurimit, si pjesë e kuptimit

<sup>38</sup> Subjekti ka paraqitur: një pjesë e akteve të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2018; kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes; njoftim akuze; procesverbal mbi veprimet e përgjimit ambiental; akt ekspertimit vlerësues të provave materiale; kërkesë për vlefësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit; vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit; vendimin gjyqësor për zëvendësimin e masës së sigurimit; procesverbalin e seancës gjyqësore; vendimin e dënimit të shtetasit F. G.

<sup>39</sup> Shihni vendimin e Gjykatës së Lartë, nr. 7, datë 14.10.2011, sipas të cilit nëse ndryshojnë nevojat e sigurimit, pra nëse rrethanat ndryshojnë, gjykata mund të revokojë ose ndryshojë masën e dhënë më parë (neni 260) apo të caktojë një masë të re nëse lind përsëri nevoja e sigurimit. Prandaj, në vështrim të interpretimit të ligjit procedural penal të parashtruar më sipër në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se masa e sigurimit mund të caktohet në çdo fazë të procedimit penal, sa herë që nga gjykimi del se kanë lindur, ndryshuar apo mungojnë kushtet paraprake dhe kriteret e rrezikut të parashikuara nga neni 228 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Kjo gjendje “rreziku” mund të verifikohet, pra mund të lindë, ndryshojë apo mbarojë, rast pas rasti, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë fazës së gjykimit. Vendimi lidhur me caktimin e masës së sigurimit apo për zëvendësimin, revokimin e shuarjen e saj jepet për gjendjen në të cilin është

dhe zbatimit të ligjit procedural penal, nuk ka lidhje me parimin e mosrëndimit të pozitës së të gjykuarit, sepse ky parim gjen zbatim vetëm në kuptimin e zbatimit të ligjit penal material. Prokurori ose i pandehuri që kanë paraqitur kërkesë për caktimin, revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit kanë barrën e provës të argumentojnë para gjykatës se kanë lindur apo ndryshuar nevojat e sigurimit apo rrethanat e faktit lidhur me të.

104. Në përfundim të sa është analizuar më sipër, si dhe pas shqyrtimit të procesverbalit të seancës gjyqësore të paraqitur në cilësinë e provës nga subjekti, ka rezultuar se subjekti ka argumentuar në mënyrë të plotë dhe shteruese zëvendësimin e masës së sigurimit. Në këto kushte nuk konstatohen *indicie* lidhur me favorizim të mundshëm të të dyshuarit në çështjen në analizë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

**ii. Në lidhje me çështjen penale me të dyshuar shtetasin O. M., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Drejtim të automjetit në mënyrë të parregullt”**

105. Nga analizimi i dokumentacionit ka rezultuar se organi i Prokurorisë i përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit ka depozituar brenda afatit 48 orë kërkesën për “Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit”, si dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” e po ashtu edhe gjykimin e drejtpërdrejtë të çështjes penale<sup>40</sup>. Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.12.2018, ka pranuar kërkesën e organit të akuzës, duke e vleftësuar të ligjshëm arrestimin, caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, si dhe gjykimin e njëkohshëm të çështjes penale. Gjatë gjyimit të çështjes me gjykim të shkurtuar, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar përfundimisht deklarin fajtor, dënimin me 1 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 406/a/1 të gjyimit të shkurtuar, dënimin e shtetasit me 20 ditë burg, të shoqëruar me dënimin plotësues ndalimin e tij të drejtjohë automjete për një periudhë 1-vjeçare<sup>41</sup>. Pas analizimit të kushteve, Gjykata me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.12.2018, ka vendosur deklarin fajtor dhe dënimin me 15 ditë burgim e në aplikim të nenit 406/1, uljen e dënimit me 1/3 e tij, me 10 ditë burgim, zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit<sup>42</sup>, vendim i cili sipas shënimit ka marrë formë të prerë.

106. Nga analiza e vendimit të sipërcituar, Komisioni ka konstatuar se përgjatë kërkesave procedurale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk janë konstatuar problematika/shkelje procedurale që mund të konfirmojë dyshimet mbi favorizim të palës në këtë proces, duke qenë që caktim i masës së dënimit të kërkuar fillimisht prej tij ka qenë brenda marzhit të parashikuar nga dispozita përkatëse e kësaj vepre penale, duke mos gjetur kështu elemente të mjaftueshme procedurale që mund të çonin në një favorizim të mundshëm të palës në këtë çështje penale.

**iii. Në lidhje me çështjen penale me të pandehur shtetasin S. H., i akuzuar për veprat penale “Ndërtimi i paligjshëm”<sup>43</sup> dhe “Ndotja e ujërave”<sup>44</sup>, organi i Prokurorisë është përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit Elidon Hysenaj<sup>45</sup>. Nga analizimi i vendimit nr. \*\*\*,**

---

*procedimi, për gjendjen në të cilën janë aktet, për rrethanat e faktit e të ligjit në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe shqyrtimit të saj nga gjykata.*

<sup>40</sup> Sipas kërkesës së të pandehurit për gjykim të shkurtuar, duke u kthyer dosja hetimore në dosje gjyqësore.

<sup>41</sup> Neni 291 i Kodit Penal, për këtë veprë penale, ka parashikuar një dënim nga 10 ditë deri në 3 vjet burgim.

<sup>42</sup> Bazuar në nenin 53/a të ligjit nr. 98, datë 31.7.2014: “Kur gjykata... çmon se vepra penale dhe autori kanë rrezikshmëri të ulët... dhe kur cakton një dënim gjer në 2 vjet, mund të vendosë zëvendësimin e dënimit të burgimit me një shumë të hollash...”.

<sup>43</sup> Neni 199/a/2 “Ndërtimi i paligjshëm” dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet.

<sup>44</sup> Neni 203/1 “Ndotja e ujërave” dënohet me burgim një gjer në 5 vjet.

<sup>45</sup> Bashkëlidhur dokumentacionit të kërkuar edhe kopje të CD-së së seancës gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit personal.



datë 24.1.2017<sup>46</sup>, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit brenda afatit procedural prej 48 orësh ka kërkuar vleftësimin e ligjshëm të arrestimit dhe caktimin si masë sigurie “Garanci pasurore”, kërkesë e kërkuar edhe nga përfaqësuesi i të dyshuarit. Nga dëgjimi i seancës gjyqësore të datës 24.1.2017 duken të paqarta dhe të paargumentuara prej prokurorit shkaqet mbi ndryshimin e masës së sigurimit personal nga “Arrest me burg”<sup>47</sup>, kërkesë fillimisht e kërkuar prej tij, në masën “Garanci pasurore”, e kërkuar përfundimisht në seancë. Komisioni, pasi analizoi vendimin e gjykatës, arriti në përfundimin se duket e paqartë kërkesa e subjektit të rivlerësimit, e ndryshme nga ajo e kërkuar fillimisht me kërkesën përfundimtare, “Garanci pasurore”.

107. Lidhur me sa është përshkruar më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me zëvendësimin e masës së sigurimit, duke specifikuar shkaqet dhe rrethanat që kishin çuan në zëvendësimin e saj.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

108. Subjekti ka parashtruar se në datën 23.1.2017, organi procedues i është drejtuar gjykatës me kërkesë për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Një ditë më pas është zhvilluar seanca gjyqësore. Gjatë kësaj seance është administruar akti i ekspertimit teknik, i cili nuk disponohej deri në momentin e paraqitjes së kërkesës. Nga akti i ekspertimit është arritur në konkluzionin se objektet ishin ndërtuar mbi 10 vjet më parë, ndërsa grumbulli i dheut nuk sillte ndotje të detit. Gjithashtu, sipas informacionit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Vlorë, sasia e mbetjeve nuk kishte shkallë rrezikshmërie për ekuilibrin ekologjik dhe biodiversitetin. Bazuar në këto të dhëna, ku ndërkohë vihej në diskutim ekzistenca e faktit penal, ai ka vlerësuar se në ndryshim nga kërkesa, masa më e përshtatshme ishte ajo e garancisë pasurore. Pavarësisht rezultatit të aktit të ekspertimit, në vijim do të kryheshin hetime të tjera, prandaj ishte e domosdoshme edhe një masë sigurimi në raport të drejtë me rëndësinë e faktit.
109. Më tej, duke qenë se në datën 3.4.2017 subjekti është komanduar në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, hetimet janë ndjekur nga drejtuesi i Prokurorisë.
110. Lidhur me vijimësinë e kësaj çështjeje, subjekti ka parashtruar se me vendimin e datës 18.4.2017 është vendosur pushimi i hetimeve ndaj shtetasit S. H., pasi nuk kanë rezultuar elemente të veprave penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal dhe “Ndotja e ujërave”, parashikuar nga neni 203/1 i Kodit Penal<sup>48</sup>.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

111. Trupi gjykues, pasi analizoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me çështjen në analizë, çmon se ndryshimi i masës së sigurisë nga ana e subjektit është bërë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga neni 260 i Kodit të Procedurës Penale dhe nuk

<sup>46</sup> Vendim që ka marrë formë të prerë.

<sup>47</sup> Masë e cila duket se është kërkuar nga subjekti i rivlerësimit fillimisht, kjo si rezultat i deklarimit në seancë gjyqësore në minutat 7.25 dhe 12.14.

<sup>48</sup> Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka paraqitur: një pjesë të akteve të procedimit penal nr. 26 të vitit 2017; vendimin për pushimin e çështjes; procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes; vendimin për caktimin e ekspertit dhe aktin e ekspertimit; procesverbalin mbi seancën gjyqësore; kërkesën për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit; vendimin e gjykatës; shkresën e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, qarku Vlorë; urdhërkomandimin e Prokurorisë së Rrethit Vlorë dhe ndërprerjen e komandimit.

evidentohen shkaqe apo *indicie* që dëshmojnë për qëllime favorizimi të palës në çështjen penale në fjalë. Për më tepër, si një garanci shtesë në drejtim të përjashtimit të dyshimeve të mundshme për favorizim paraqitet fakti se gjykata ka pranuar si të ligjshme kërkesën e subjektit, duke vendosur me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.1.2017, pranimin e saj. Referuar dispozitës së sipërcituar, gjykata në çdo kohë, kur konstaton se dinamika e çështjes ka ndryshuar, mund të vendosë të ndryshojë sërish masën e sigurisë. Një tjetër element i rëndësishëm që vlen të përmendet është edhe fakti se vijimi i hetimeve për çështjen në fjalë është ndjekur nga një tjetër prokuror, i cili nuk ka rezultuar të ketë ndërmarrë ndonjë veprim lidhur me masën e sigurisë në raport me dinamikën e çështjes, ndërkohë që *de jure*, bazuar në nenin 260 të Kodit të Procedurës Penale, e ka pasur gjithashtu mundësinë për të kërkuar ndryshimin e saj.

112. Gjithashtu, vlen të përmendet fakti se çështja në fjalë në vijim është pushuar, për shkak se nuk ekzistonte fakti penal, çka dëshmon sërish në drejtim të mungesës së *indicieve* për favorizim të mundshëm të palës nga ana e subjektit të rivlerësimit, në këtë proces penal.
113. Gjithashtu, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2023, vuri në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, i cili është analizuar në vijim.

**iv. Lidhur me kërkesën e datës 24.1.2017 për gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. \*\*\*, në ngarkim të shtetasit L. M.<sup>49</sup>, i akuzuar për veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”**

Ka rezultuar se lidhur me këtë çështje subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar organin e akuzës dhe ka kërkuar vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, si dhe gjykimin e menjëhershëm të këtij procedimi. Lidhur me kërkesën për gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal dhe caktimin e masës “Arrest në burg”, me të drejtë subjekti ka analizuar kushtet dhe kriteret, pasi arrestimi i shtetasit është kryer në flagrancë, si dhe ka argumentuar kriteret e parashikuara që ekzistojnë midis raportit të drejtë që ekziston midis rëndësisë së faktit të ndodhur dhe sanksionit që parashikon kjo veprë penale.

114. Nisur nga sa më lartpërshkruar, bazuar në dokumentet e administruar, por edhe nga të dhënat e disponuara nga Komisioni, nuk janë evidentuar shkelje procedurale, veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit që mund të konfirmojnë faktet e dyshuara lidhur me favorizimin e mundshëm të shtetasit në çështjen e analizuara, për aq kohë sa kërkesat në këtë fazë të hetimit kanë qenë më ekstremet e mundshme, ndonëse në përputhje me dispozitat e neneve 291, 400/1/2 etj. të Kodit të Procedurës Penal, si dhe janë pranuar e miratuar nga gjykata.

**v. Lidhur me vendimin për pezullimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016, i cili bën fjalë për veprën penale “Vjedhje e energjisë elektrike”**

115. Subjekti i rivlerësimit në datën 28.12.2016 ka marrë vendimin për pezullimin e procedimit penal në bazë të nenit 326/4-2 të Kodit Penal, me argumentimin se nuk njihet autori i veprës penale, duke e dërguar dosjen e këtij procedimi penal në Komisariatin e Policisë Sarandë, për zbulim autori. Kështu, mbi bazën e materialit të paraqitur nga Njësia Operacionale

---

<sup>49</sup> Në datën 23.1.2017, nga Komisarjati i Policisë është ndaluar shtetasi që udhëtonte me disa pasagjerë, të cilët nuk kishin vendosur rripat e sigurimit – detyrim i parashikuar nga neni 170 i Kodit Rrugor. Në momentin e ndalimit ai ka tentuar t’u japë një shumë prej 2.000 lekësh punonjësve të policisë rrugore, në mënyrë që të shmange gjobën.

Elektrike është ushtruar një kontroll në disa subjekte në qytetin e Sarandës, duke konstatuar se në një ndërtesë matësi i energjisë elektrike dukej i dëmtuar nga pamja vizuale dhe vula nuk figuronte në sistemin e OSHEE-së. Nga verifikimet rezultoi se ky matës i përkiste abonentit S. N. Pas konstatimit janë njoftuar organet përkatëse për testimin e matësit, të cilët kanë konstatuar se elementet e sigurisë janë cenuar, duke bërë të mundur hapjen e kapakut dhe ndërhyrjen në numëror. Policia ka pyetur shtetasin V. N., i cili ka deklaruar se është djali i shtetasës S. N., e cila jeton në Greqi dhe ka sqaruar se këtë objekt e kanë dhënë me qira ndër vite.

116. Në funksion të hetimeve, organi i akuzës ka pyetur personat që kanë pasur ndër vite me qira këtë ndërtesë, të cilët kanë deklaruar se nuk kanë dijeni për ndërhyrjen në matësin energjisë. Më pas, referuar korrespondencave të OSHEE-së Sarandë, është bërë me dije se tek abonenti S. N. nuk është bërë ndërhyrje në matës dhe testimi i fundit është bërë në datën 12.8.2013, e cila është edhe periudha që është konstatuar ndërhyrja në matës. Gjithashtu, OSHEE-ja ka dërguar edhe kopje të historikut të faturimit të kontratës së abonentit S. N., ku nuk vërehen ndryshime të theksuara, së paku nga vitit 2009 e deri në ato momente, po ashtu edhe në nivelin e pagesave me ato të periudhës paraardhëse. Nga sa më lart, organi i Prokurorisë nuk ka bërë të mundur të zbulohen autorët e mundshëm të kësaj ngjarjeje, duke mos u arritur të përcaktohet periudha kohore kur ka ndodhur ndërhyrja apo cili ka qenë personi konkret që ka kryer këtë ndërhyrje, duke u nisur nga fakti se ky objekt ndër vite ka qenë në përdorim nga persona të ndryshëm, sipas deklarimeve nga këta shtetas e jo vetëm nga pronari/abonenti S. N., si dhe nisur edhe nga fakti se nga OSHEE-ja nuk janë ushtruar kontrole gjatë kësaj periudhe.

117. Nisur nga sa më sipër është përshkruar, bazuar në dokumentet e administruara dhe nga të dhënat e disponuara nga Komisioni, nuk janë evidentuar shkelje procedurale, veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit që mund të konfirmojnë faktet e dyshuara lidhur me favorizimin e mundshëm të shtetasës S. N. në çështjen penale të sa më sipër analizuar.

**vi. Lidhur me materialin kallëzues nr. \*\*\* të vitit 2020, që i referohet materialit kallëzues<sup>50</sup> të referuar nga Komisariati i Policisë Sarandë, datë 25.5.2020, për veprën penale “Vjedhje me dhunë”<sup>51</sup>**

118. Nga analizimi i praktikës rezulton se prokurori ka marrë vendim në datën 9.6.2020 për mosfillimin e procedimit penal të materialit kallëzues nr. \*\*\* të vitit 2020. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se midis shtetasve ka nisur një konflikt/përleshje fizike që është shoqëruar me dëmtime fizike, si dhe është pretenduar për vjedhjen e një zinxhiri nga shtetasi M. A. Në vijim të hetimeve nga organi i akuzës janë marrë deklaratimet e personave të përfshirë, si dhe është provuar fakti se konflikti ka pasur shkak marrëdhënien midis ish-bashkëshortes Z. V. të shtetasit H. S. Gjithashtu, pasi është ripyetur shtetasi H. S., ai ka deklaruar se lidhur me zinxhirin e pretenduar si të vjedhur nuk ka qenë i bindur nëse është marrë nga shtetasi M. A. Në vijim të hetimeve është ushtruar kontroll në banesën e shtetasve dhe nuk ishte arritur të gjendej sendi në fjalë.

<sup>50</sup> Bashkëlidhur, vendimi për mosfillimin, kopje e njoftimit, referimi i policisë, deklaratat e personave, si dhe procesverbalet përkatëse.

<sup>51</sup> Midis shtetasve H. S. dhe M. A. është zhvilluar një konflikt, duke u shoqëruar me përleshje. Shtetasi H. S. ka akuzuar se gjatë përleshjes atij i është vjedhur një zinxhir nga shtetasi M. A. Konflikti ka lindur pasi shtetasi M. A. ka marrë një banesë me qira në banesën ku jetonte ish-bashkëshortja Z. V. e shtetasit H. S., duke i dërguar kësaj të fundit edhe mesazhe denigruese.

119. Në analizim të situatës faktike dhe dokumentacionit, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 59 të Kodit Penal, ka vlerësuar se veprimet e sipërcituara nuk përbëjnë fakt penal dhe në datën 9.6.2020 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke orientuar gjithashtu edhe palët për ndjekjen e këtij konflikti në rrugë civile, që parashikojnë edhe shpërblimin e dëmit si një proces që ndiqet drejtpërdrejt nga gjykata nga i dëmtuari akuzues. Për këtë vendim janë njoftuar edhe palët.
120. Nisur nga sa më sipër është përshkruar, bazuar në dokumentet e administruara dhe nga të dhënat e disponuara nga Komisioni, nuk janë evidentuar shkelje procedurale, shkelje ligjore apo tejkalim të afateve procedurale, veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, që mund të konfirmojnë faktet e dyshuara lidhur me favorizimin e mundshëm të ndonjëris nga palët e përfshira në çështjen penale të sa më sipër analizuar.
121. Në përfundim, në vlerësim të rezultateve të hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit Elidon Hysenaj, trupi gjykues ka konstatuar se *indiciet* nuk janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera, të rezultuara gjatë hetimit administrativ. Vetë subjekti i rivlerësimit ka dhënë qëndrimin e tij lidhur me veprimet hetimore të kryera, në raport me detyrimin e tij për arsyetimin ligjor e argumentin logjik të përdorur rast pas rasti gjatë hetimit të çështjeve të analizuar. Parë në tërësinë e tyre, të gjitha *indiciet* e mbledhura në raport me veprimet procedurale hetimore konkrete të subjektit të rivlerësimit, për çështjet objekt shqyrtimi, konstatohet se nuk përmbajnë të dhëna të nevojshme për të vlerësuar se ka rrethana që krijojnë bindjen se subjekti me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia dhe as nuk mund të konkludohet se ka pasur shkelje ligjore që mund të kualifikohen brenda dispozitave të kreut “V Kontrolli i figurës” apo konkretisht nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, apo të përbëjnë mangësi profesionale.

### C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

122. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Elidon Hysenaj, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
123. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese, burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
124. Raporti nr. \*\*\* prot., datë 23.7.2018,, i përcjellë nga KLP-ja, është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative; (iii) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.
125. Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e rivlerësimit tetor 2014 – 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Elidon Hysenaj, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

126. Prokuroria e Përgjithshme<sup>52</sup> ka bërë me dije se në datën 31.3.2017 është paraqitur një kërkesë nga shtetasi Dh. Q., me objekt “Përfashtimi nga hetimi gjyqësor i prokurorit Elidon Hysenaj”. Kjo kërkesë i është drejtuar edhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila me vendimin e datës 31.3.2017 ka vendosur “Mospranimin e kërkesës së ankuesit”<sup>53</sup>.
127. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka paraqitur informacionin lidhur me kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 26.7.2018, ndaj subjektit të rivlerësimit për veprat penale “Shpërdorim detyre” “Detyrim për kallëzimin e provave” dhe “Zhdukja ose humbja e fashikullit”, të parashikuara nga nenet 248/304 dhe 313/a të Kodit Penal. Për këtë kallëzim është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 31.7.2018.

### **C/1. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni**

128. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet publike, të administruara për këtë qëllim. Për sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, Komisioni ka konstatuar sa vijon:

**i. Në lidhje me dokumentin nr. 1** – vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016, të analizuar në raportin e KLGJ-së

129. Komisioni e kishte ftuar subjektin të paraqiste shpjegime në lidhje me “Rrëzimin e kërkesës penale nr. \*\*\*, datë 13.12.2016” nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, si dhe në lidhje me njoftimin e kallëzueses për mosfillimin e çështjes në datën 11.12.2016, pra përtej afatit të parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

130. Subjekti ka parashtruar se në datën 13.9.2016 është marrë vendimi i mosfillimit dhe sipas praktikës që ndiqej në atë periudhë, në të njëjtën datë është dorëzuar fashikulli i materialit kallëzues në sekretari dhe kjo e fundit, pasi bënte shkresat përkatëse për njoftimet e palëve, ia përcillte materialin hetimor drejtuesit të Prokurorisë. Pasi dosja kontrollohej nga drejtuesi i përcillej sërish sekretarisë, e cila më pas dërgonte njoftimet në adresat përkatëse.
131. Nga aktet e fashikullit hetimor rezulton se me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2016, nga sekretaria i është dërguar një kopje e vendimit të mosfillimit kallëzueses. Nga ana tjetër, kjo e fundit, në datën 11.12.2016, kundrejt nënshkrimit ka marrë një kopje të vendimit të mosfillimit.
132. Në lidhje me njoftimin, Kodi i Procedurës Penale në fuqi i kohës parashikonte se vendimi i mosfillimit i komunikohet menjëherë palëve dhe nuk ka pasur një afat të mirëpërcaktuar procedural brenda të cilit duhej t’i nisej një kopje vendimit të mosfillimit palëve. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës një kopje të vendimit të mosfillimit dhe njoftimit të palës.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

<sup>52</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2018.

<sup>53</sup> Drejtuesi i Prokurorisë në vendimin e tij ka arsyetuar se mosqenia dakord e kallëzuesit me vendimmarrjen e prokurorit, në kushtet kur nuk paraqitet asnjë fakt konkret që krijon dyshime për ndikime tek prokurori i çështjes apo njëanshmëri në hetim apo gjykim, nuk përbën shkak për përfashtimin e prokurorit. Për më tepër, drejtuesi arsyetonte se vendimi i prokurorit është i ankimueshëm dhe kallëzuesi ka të gjitha mundësitë ligjore për të ezauruar mjetin e ankimit.

133. Trupi gjykues, pas analizimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrimet ligjore sa i përket njoftimit të kallëzueses lidhur me vendimin e mosfillimit, vëren se bazuar në pikën 2 të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale të kohës kur është dhënë vendimi nga ana e subjektit të rivlerësimit, përcaktohet: *“Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit”*. Sikurse evidentohet nga dispozita në fjalë, nuk ka një afat konkret për njoftimin e vendimit dhe as një detyrim ligjor që ngarkon me përgjegjësi prokurorin e çështjes lidhur me procedurën e njoftimit. Njoftimi i palëve lidhur me vendimmarrjen përbënte një procedurë që kryhej nga ana e sekretarisë, e cila siç rezulton nga aktet ka realizuar njoftimin zyrtarisht. Pavarësisht se kallëzuesja ka marrë dajeni me vonesë, asaj nuk i është mohuar e drejta e ankimit. Në rastin konkret ajo e ka realizuar këtë të drejtë. Në këto kushte nuk evidentohen shkelje procedurale të të drejtave të palës e, për rrjedhojë, nuk konstatohen veprime apo mosveprime që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin, në kuadër të vlerësimit të kriterit profesional.

**ii. Në lidhje me dokumentin nr. 2** – që i përket materialit kallëzues nr. \*\*\* të vitit 2016, të analizuar në raportin e KLGJ-së

134. Komisioni e kishte ftuar subjektin të paraqiste shpjegime në lidhje me veprimet hetimore të kryera gjatë hetimit të çështjes së sipërcituar.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

135. Subjekti ka parashtruar se lidhur me procedimin penal në fjalë, pas kallëzimit të shtetasit A. Dh., nga ana e tij janë kryer një sërë veprimesh hetimore verifikuese, të tilla si: administrimi nga Njësia Administrative \*\*\* të formularëve nr. \*\*\* për fshatin \*\*\*, për shtetasit A. Dh. dhe Q. N.; është pyetur shtetasi P. N. Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se dokumentet objekt kallëzimi gjendeshin në fotokopje dhe për këtë arsye ishte objektivisht e pamundur të kryhej ekspertimi i tyre, në mënyrë që të vlerësohej nëse ato ishin lëshuar ose jo nga persona përgjegjës, sipas nënshkrimeve përkatëse. Për rrjedhojë, subjekti ka vlerësuar se këto dokumente duhet t'i nënshtroheshin një hetimi gjyqësor, apo një kontrolli administrativ nga organe kompetente.

136. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se komisionet e ndarjes së tokës kanë funksionuar para viteve 2000, për rrjedhojë, edhe nëse do të provohej se dokumentet objekt kallëzimi ishin lëshuar në kundërshtim me ligjin, për shkak të afatit të parashkrimit nuk mund të ushtrohej ndjekja penale. Konkretisht neni 66/c i Kodit Penal, parashikon: [...] *nuk mund të ushtrohet ndjekja penale kur kanë kaluar 5 vjet për krimet që parashikojnë dënim deri në 5 vjet burgim [...]* etj.

137. Në këto kushte, subjekti ka vlerësuar se bazuar në dokumentacionin objekt kallëzimi, si dhe atë të administruar përgjatë hetimit, është konkluduar se përpos mos evidentimit të elementeve të veprës penale të dushuar, ekzistonin edhe shkaqe ligjore të cilat nuk lejonin fillimin e procedimit penal<sup>54</sup>.

<sup>54</sup> Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentacionin:

- Vendim për pushimin e çështjes penale, vendim i Gjykatës së Apelit, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. \*\*\*, datë 29.9.2016 dhe datë 6.11.2017.

- Vendim për mosfillimin e procedimit penal, kërkesë drejtuar Njesisë Administrative \*\*\* dhe kthim përgjigjeje, deklaram P. N., shkresë noterit A. A. dhe kthim përgjigjeje.

## Vlerësimi i trupit gjykues

138. Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit, si dhe shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur prej tij, trupi gjykues çmon se argumenti i subjektit të rivlerësimit se ekspertimi nuk mund të kryhej për shkak se dokumentet disponoheshin vetëm në fotokopje, është i drejtë dhe i bazuar edhe në praktikën gjyqësore, siç është edhe qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 18, datë 23.6.2006, në të cilin citohet: *“Gjykata Kushtetuese çmon se kërkuetit nuk arritën të provojnë pretendimet e tyre për mungesën e komunikimit të rekursit. Paraqitja prej tyre e aktit të ekspertimit grafik për të vërtetuar falsitetin e nënshkrimit, për rastin në shqyrtim, nuk përbën provë. Ky arsyetim mbështetet në faktin se ekspertimi nuk është kërkuar në mënyrën e përcaktuar në ligj dhe se është kryer mbi bazën e një fotokopje dhe jo dokumentit origjinal”*. Në këtë këndvështrim, për sa kohë subjekti ka bërë të gjitha përpjekjet duke kërkuar nga institucionet që kishin në administrim dokumentet origjinale kjo nuk është bërë e mundur (sikurse është konfirmuar në përgjigjet e tyre), pasi ka rezultuar se ato disponoheshin vetëm në fotokopje.
139. Vendimmarrja e subjektit është ankimuar dhe çështja është kthyer për hetime të mëtejshme nga Gjykata e Apelit. Në vijim janë kryer disa veprime hetimore shtesë si: i është kërkuar informacion Zyrës së Kadastrës Sarandë lidhur me rastin në fjalë; i është kërkuar informacion Zyrës Vendore të Pasurive të Paluajtshme Sarandë dhe Prefekturës Vlorë, Ministrisë së Financave/Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike, Këshillit të Qarkut Vlorë, Njesisë Administrative \*\*\*, noterit A. A., Sarandë.
140. Në datën 3.4.2017, subjekti është komanduar me detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe hetimet janë ndjekur nga drejtuesi i Prokurorisë, i cili ka vendosur pushimin e procedimit, pasi edhe nga hetimet e kryera nuk kanë rezultuar të dhëna të ndryshme nga ato të konstatuara fillimisht me vendimin e mosfillimit. Pas ankimit, gjykatat e të dyja shkallëve e kanë lënë në fuqi vendimin e pushimit.
141. Ndonëse janë kryer veprime hetimore shtesë, sërish ato nuk kanë rezultuar produktive në drejtim të evidentimit të ndonjë fakti penal. Të dyja gjykatat kanë lënë në fuqi vendimin e pushimit.
142. Në përfundim të sa është analizuar më sipër, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprimet hetimore, sipas/dhe në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për qartësimin e rrethanave konform nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Për pasojë, trupi gjykues nuk ka konstatuar shkelje procedurale në vlerësimin e subjektit në lidhje me këtë procedim penal.

## DENONCIME

143. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur 4 denoncime nga publiku, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të analizimit të materialeve përkatëse lidhur me disa denoncime, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për vlerësime më të thella lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet

---

- Shkresë e Njesisë Administrative \*\*\* dhe kthim përgjigjeje; shkresë Zyrës së Gjendjes Civile \*\*\*/certifikatë familjare; shkresë Këshillit të Qarkut Vlore dhe kthim përgjigjeje; shkresë e ZVRPP-së Sarandë dhe kthim përgjigjeje; shkresë e Prefekturës Vlorë dhe kthim përgjigjeje.  
- Shkresë Ministrisë së Financave dhe kthim përgjigjeje; shkresë e Zyrës së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Sarandë.

që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar se nga përmbajtja e një pjese të tyre nuk janë evidentuar prova mbi shkelje të mundshme të subjektit apo *indicie* mbi të cilat të mund të kryhej ndonjë hap hetimor i mëtejshëm. Ndërsa mbi disa të tjerë janë kryer hetime të thelluara dhe janë administruar dokumente dhe informacione shtesë, siç janë trajtuar në vijim:

**1. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2019, i shtetasit A. K.**

144. Denoncuesi nuk ka ngritur ndonjë pretendim ndaj subjekti, por ka bashkëlidhur vendimin e mosfillimit nr. \*\*\* të vitit 2016, të dhënë prej tij. Vendimi në fjalë ka rezultuar i prishur dhe i kthyer për rihetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.3.2017, e cila ka arsyetuar ndër të tjera se vendimi është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe se analiza juridike është e gabuar dhe nuk gjen mbështetje në ligj<sup>55</sup>.
145. Ndonëse vendimi i Gjykatës i sipërcituar është ankimuar nga prokurori Elidon Hysenaj në datën 29.3.2017, ai është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.5.2017.
146. Në vijim, çështja në fjalë është ndjekur nga një tjetër prokuror, i cili në përfundim ka vendosur pushimin e procedimit penal.
147. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me veprimet hetimore të kryera prej tij, në çështjen objekt denoncimi.

**Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

148. Subjekti ka parashtruar se në lidhje me kallëzimin nr. \*\*\*, të paraqitur nga shtetasi A. K. ndaj shtetasit R. B., për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në Bashkinë Delvinë është administruar dokumentacioni i mbajtur në lidhje me dhënien e licencës së transportit të udhëtarëve shoqërisë “\*\*\*”. Pas verifikimeve të kryera dhe analizës së materialeve të grumbulluara në kuadër të këtij kallëzimi është arritur në përfundimin se ekzistonin shkaqe ligjore të cilat nuk lejonin fillimin e procedimit penal.
149. Subjekti ka arsyetuar se procedurat që ndiqen për dhënin e licencave subjekteve transportuese kanë për bazë udhëzimin nr. 15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” të ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Sipas pikës 3 të nenit 7 të këtij udhëzimi është bashkia e stacionit fundor të linjës që miraton oraret e kthimit për subjektet e bashkive/komunave ku fillon linja. Bashkia/komuna lëshon përkatësisht vërtetim ose konfirmim për miratimin e orareve të kthimit në përshtatje me kërkesën për transport të udhëtarëve. Sa i takon rastit në fjalë, ishte Bashkia Tiranë ajo që miratonte orarin e kthimit për subjektet e bashkive/komunave.
150. Për sa më sipër, është vlerësuar se në veprimtarinë e shtetasit R. B., apo punonjësve të tjerë të kësaj bashkie të përfshirë në procesin e dhënies së licencës së transportit subjektit “\*\*\*” nuk konstatoheshin veprime në kundërshtim me ligjin dhe me përmbushjen e rregullt të detyrës.

---

<sup>55</sup> Gjykata ka orientuar për hetime të mëtejshme dhe administrim të provave dhe hetimin lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit.



151. Pas kthimit të akteve nga gjykata, çështja është ndjekur sërish nga subjekti<sup>56</sup> dhe në datën 24.1.2020 ai ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar<sup>57</sup>.
152. Lidhur me këtë çështje është paraqitur ankim edhe pranë ILD-së nga shtetasi A. K., i cili me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.7.2023, ka vendosur arkivimin i ankesës, pasi është konstatuar se veprimet hetimore të ndjekura nga subjekti gjatë periudhës që ka qenë i ngarkuar me hetimin e këtij rasti kanë qenë të arsyeshme. Subjekti ka paraqitur si provë vendimin nr. \*\*\*, datë 26.7.2023, të ILD-së, si dhe ankimin kundër vendimit gjyqësor.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

153. Trupi gjykues, përpos shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vendimit të lartpërmendur të ILD-së, çmon se në këtë rast subjekti nuk ka ndërmarrë të gjitha veprimet paraprake verifikuese/vlerësuese dhe hetimore, në kohën dhe mënyrën e duhur, përpara se të mbërrinte në vendimin e mosfillimit nr. \*\*\*, viti 2016.
154. Nisur nga fakti se subjekti fillimisht ka vendosur mosfillimin e procedimit penal dhe më tej, pas vendimit të gjykatës për urdhërimin e kryerjes së hetimeve, është vlerësuar dhe shprehur moskompetencë lidhur me këtë çështje/procedim, evidenton mungesën e mjaftueshmërisë në kryerjen e hetimeve e vlerësimeve fillestare nga ana e tij. Megjithatë, kjo çështje e vetme nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për penalizimin e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të vlerësimit profesional.

### **2. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2018, i shtetasit E. S.**

155. Denoncuesi ka ngritur pretendime lidhur me kërkesën e subjektit për vleftësimin e masës së arrestit me burg, duke parashtruar se kërkesa në fjalë ka qenë e pabazuar në prova. Kërkesa në fjalë ka rezultuar e pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.1.2017.
156. Pas vendimit të Gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, organi i Prokurorisë ka kryer disa veprime hetimore në kuadër të këtij procedimi penal, si kryerja e aktit të ekspertimit teknik, verifikimi i numrit të telefonit në kompanitë përkatëse, kryerja e veprimit procedural të paraqitjes për njohje direktet të personit të dyshuar E. S. – nga ku nëpërmjet procesverbalit për njohje të personit shtetasja e dëmtuar ka identifikuar të dyshuarin si autor të kryerjes së veprës penale.
157. Pas identifikimit të automjetit, targës dhe personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale, në datën 16.2.2017 – i cili nuk ishte shtetasi E. S., subjekti ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, kërkesë e cila është pranuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.2.2017.
158. Pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe ndryshimit të dinamikës së ngjarjeve të zbuluara më tej, subjekti ka vendosur *pushimin e hetimeve në ngarkim të denoncuesit, si dhe shuarjen e masës së sigurimit personal*.

<sup>56</sup> Subjekti ka sqaruar se përgjatë periudhës prill 2017 – janar 2018 ka qenë i komanduar në të njëjtën detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Përgjatë periudhës dhjetor 2018 – tetor 2019 ka qenë i komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>57</sup> Subjekti ka deklaruar se çështja është ende në hetim.

159. Në përfundim, pas analizimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni, lidhur me sa është parashtruar më sipër, nuk janë evidentuar shkelje të subjektit apo *indicie* për thellimin e hetimeve<sup>58</sup>.

### **3. Kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2019, e shtetasit Sh. I.**

160. Në kërkesën drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas këtij shtetasi, subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar kallëzimin e tij dhe se çështja ka kaluar tek një tjetër prokuror. Nuk janë konstatuar problematika apo *indicie* për thellimin e këtij hetimi lidhur me këtë kërkesë, duke qenë se çështja në fjalë nuk është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, sikurse shprehet edhe vetë denoncuesi. Gjithsesi, kjo kërkesë nuk i drejtohej Komisionit dhe nuk përmbante elementet e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

### **4. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2022, i shtetasit E. B.**

161. Denoncuesi ka parashtruar se ka bërë dy kallëzime pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Kallëzimin e parë e ka bërë për veprat penale “Ndërtimi i paligjshëm”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzimi i krimit”, të ndjekura prej subjektit të rivlerësimit dhe ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. \*\*\* viti 2020, ndërsa për kallëzimin e dytë mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2020. Për të dyja rastet nga gjykata është vendosur vijimi i hetimeve.

162. Nga verifikimi në sistemin *online* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka rezultuar se:

**a. Lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2020**, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për veprat penale “Ndërtimi i paligjshëm”, “Pushtimi i tokës”, “Shpërdorimi i detyrës”, vendim që është ankimuar nga denoncuesi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2021, ka vendosur shfuqizimin e vendimit dhe vazhdimin e hetimeve.

**b. Lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2020**, subjekti i rivlerësimit, pas shqyrtimit të provave të administruara, aktit të ekspertimit, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2020, për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, vendim i cili është ankimuar nga kallëzuesi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin e datës 7.2.2021 ka vendosur kryerjen e hetimeve shtesë nga organi i Prokurorisë.

163. Më tej, pasi janë kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga Gjykata, është konkluduar se nga ana e të kallëzuarit është kryer ndërtim i paligjshëm, ndërsa për punonjësit e IMT-së Bashkisë Sarandë është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, kallëzimi nr. \*\*\*, datë 2.11.2020, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”. Lidhur me këtë të fundit, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2021, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë dhe e ka urdhëruar të regjistrojë procedimin dhe të vazhdojë hetimin.

164. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqiste shpjegime lidhur me veprimet hetimore të kryera në funksion të këtij procedimi penal.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

165. Subjekti ka parashtruar se shtetasi E. B. ka paraqitur dy kallëzime penale në kohë të ndryshme. Fillimisht, mbi bazën e kallëzimit të tij është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*

<sup>58</sup> I njëjti denoncim është marrë në shqyrtimi edhe më parë nga Komisioni, duke mbërritur në të njëjtin konkluzion.

për veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal. Për sqarimin e rrethanave të faktit është thirrur dhe pyetur shtetasi E. V. H.; është këqyruar objekti i këtij shtetasi; është administruar në Bashkinë Sarandë një kopje e dokumenteve, që i përkasin praktikës për miratimin e deklaratës paraprake të punimeve të shtetasit E. H.; është përpiluar vendimi për kryerjen e një ekspertimi teknik. Pas administrimit të aktit të ekspertimit teknik ka rezultuar se nga verifikimi në natyrë i punimeve të kryera në këtë apartament është konstatuar se këto punime kanë rezultuar të jenë kryer duke iu përmbajtur përgjithësisht punimeve të përcaktuara në deklaratën paraprake të punimeve. Punimet e kryera në këtë apartament nga shtetasi E. H. nuk cenonin apo ndikonin në qëndrueshmërinë e objektit në tërësi.

166. Në përfundim të hetimeve, në datën 26.10.2020, organi procedues ka kërkuar në gjykatë pushimin e çështjes nr. \*\*\*, pasi fakti nuk përbënte veprën penale “Shkatërrimi i pronës”, të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal.
167. Gjatë kohës që është paraqitur në gjykatë kërkesa për pushimin e çështjes së mësipërme, në datën 2.11.2020, shtetasi E. B. ka paraqitur me shkrim një kallëzim tjetër penal, i cili është regjistruar me nr. \*\*\*. Ky kallëzim drejtohej kundër shtetasit E. H., për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal etj. dhe drejtorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Sarandë për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
168. Duke qenë se pretendimet e ngritura ishin të njëjta me ato të trajtuara në procedimin penal nr. \*\*\*, i cili ishte ende në shqyrtim në gjykatë, në datën 11.11.2020 është vendosur mosfillimi i procedimit për materialin kallëzues nr. \*\*\* të vitit 2020, mbi të njëjtat shkaqe që ishin parashtruar në kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*.
169. Lidhur me pretendimin e ri, të ngritur ndaj drejtuesit të IMT-së Sarandë, nuk janë konstatuar veprime në kundërshtim me ligjin dhe me përmbushjen e rregullt të detyrës, për sa kohë nuk janë evidentuar punime të paligjshme<sup>59</sup>.
170. Lidhur me kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin datë 27.5.2021, ka urdhëruar prokurorin që të plotësojë hetimet. Pas kryerjes së detyrave të caktuara nga gjykata, në seancën e datës 19.7.2021, nisur nga konkluzioni i aktit të ekspertimit se nga ana e të kallëzuarit është kryer ndërtim i paligjshëm, është kërkuar tërheqja e akteve të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2020.
171. Sa i takon ecurisë së materialit kallëzues nr. \*\*\*, rezulton se shtetasi E. B. ka ushtruar ankim kundër vendimit të mosfillimit dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit dhe detyrimin e organit procedues që të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetime. Mbi këtë bazë, në datën 17.9.2021 është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a, paragrafi 3 i Kodit Penal dhe veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në datën 8.10.2021, duke qenë se ekzistonin kushtet ligjore të rasteve për bashkimin e procedimeve, bazuar në nenin 92, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Penale, është vendosur bashkimi i procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2020 me procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2021 dhe më tej vazhdimi i hetimeve në një të vetëm, atë me nr. \*\*\*, për veprat penale “Shkatërrimi i pronës”,

---

<sup>59</sup> Shihni kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*.

parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal, “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a, paragrafi 3 i Kodit Penal dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal.

172. Subjekti ka deklaruar se të dhënat e mësipërme pasqyrojnë veprimtarinë e tij hetimore në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\* deri në datën 4.10.2021, pasi në këtë periudhë ai, me vendimin nr. \*\*\* të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është transferuar me detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

173. Pas analizimit të prapësimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues ka konstatuar se ndonëse subjekti i rivlerësimit në të dyja procedimet penale të analizuara më sipër ka shprehur qëndrimin e vet, sipas të cilit ai ka kryer veprimet hetimore që janë vlerësuar prej tij si të nevojshme, ndonëse ato nuk janë cilësuar të plota nga Gjykata, e cila ka vendosur kthimin e akteve për hetime të mëtejshme.
174. Komisioni – në parim dhe në mungesë të *indicieve* specifike – nuk mundet të zëvendësojë mënyrën e të vepruarit apo arsyetimin logjik të subjekteve, duke u mjaftuar me analizimin dhe verifikimin e respektimit dhe aplikimit të drejtë të dispozitave procedurale, respektimin e të drejtave të palëve, si dhe lidhur me gjithëpërfshirjen, plotësinë e hetimeve të kryera, sikurse lidhur me harmonizimin e veprimeve hetimore (mes tyre dhe në raport me dinamikën e ngjarjeve), në përputhshmëri me faktet e konstatuara dhe rrethanat e tjera faktiko-ligjore dhe lidhur me qartësinë e plotësinë e narrativës faktike e arsyetimit logjiko-juridik të vendimeve përkatëse.
175. Kësisoj, për sa kohë nuk janë referuar apo konstatuar shkelje konkrete në drejtim të aftësive profesionale të subjektit Elidon Hysenaj dhe pretendimet e denoncuesit lidhen me vendimmarrjen dhe i referohen mënyrës së vlerësimit të provave nga ana e subjektit, Komisioni, bazuar në pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk mund të gjykojë mbi vendimin e themelit të çështjes, nëse ai është i drejtë apo jo. Ky vlerësim i Komisionit mbështetet edhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin citohet: “54. Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, Gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”.
176. Për sa më sipër, çështja në analizë, ndonëse evidenton moskryerjen e hetimeve të plota, sipas vlerësimit të gjykatës – në mungesë të një serie problematikash të përsëritura dhe me pasoja konkrete, të cilat mund të evidentonin një *modus operandi* të papërshtatshëm dhe/ose mangësi të theksuara profesionale – kjo rrethanë nuk mund të mjaftojë në vetvete për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

177. Nisur nga analiza e kryer lidhur me: (i) raportin të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë; (ii) denoncimet e depozituara nga publiku dhe dokumentacionin e administruar për këtë qëllim; (iii) shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionin e paraqitur prej tij – Komisioni çmon se në një vlerësim të përgjithshëm të këtij subjekti nuk janë konstatuar shkelje të rënda procedurale, gabime thelbësore e serioze në lidhje me kryerjen dhe drejtimin e hetimeve apo vendimmarrjen nga ana e tij, kësaj nuk janë konstatuar mangësi me peshë evidente në aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.
178. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit Elidon Hysenaj ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Elidon Hysenaj:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **Për këto arsye,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Elidon Hysenaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës<sup>60</sup>.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

---

<sup>60</sup> Aktualisht – sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit përgjatë seancës dëgjimore.

Ky vendim u shpall në datën 9.10.2023.

**ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Relator**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Jonida Vrana*